



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti Juridik

Studime postdiplomike në të drejtën penale

Tema e Magjistraturës:

**Dallimi mes Grabitjes dhe Vjedhjes Grabitqare si vepra
penale kundër pasurisë**

Mentori
Doc.Dr.Besa Arifi

Kandidati
Habul Ismaili

PËRMBAJTJA :

HYRJE.....	4
------------	---

I KAPITULLI I PARË

1. Vështrimi historiko – juridik I veprave penale Grabitje dhe Vjedhjes grabitqare.....	6
1.1 Zhvillimi historik-juridik për veprat penale grabitje dhe vjedhje grabitqare.....	6
1.2 Ndryshimet dhe sfidat e shekullit XXI për veprat penale grabitja dhe vjedhja grabitqare.....	11

II KAPITULLI I DYTË

2.1 Nocioni dhe kuptimi i veprës penale të Grabitjes.....	12
2.2 Emërtimi ligjor i veprës penale të Grabitjes sipas KPM.....	13
2.3 Elementet që e përbëjnë figurën e veprës penale të Grabitjes.....	13
2.4 Trajtimi i veprës penale të Grabitjes sipas :	
2.4.1 Kodit penal të RM-së.....	15
2.4.2 Kodit penal të Shqipërisë.....	17
2.4.3 Kodit penal të Kosovës.....	20
2.5 Shqiptimi i sanksionve penale për veprën penale Grabitje.....	22

III KAPITULLI I TRETË

3.1 Nocioni dhe kuptimi i veprës penale të Vjedhjes Grabitqare.....	33
3.2 Emërtimi ligjor i veprës penale të Vjedhjes Grabitqare sipas KPM.....	34

3.3 Elementet që e përbëjnë figurën e veprës penale të Vjedhjes Grabitqare.....	34
3.4 Trajtimi I veprës penale të Vjedhjes Grabitqare sipas :	
3.4.1 Kodit penal të RM-së.....	35
3.4.2 Kodit penal të Shqipërisë.....	36
3.4.3 Kodit penal të Kosovës.....	39
3.5 Shqiptimi i sanksioneve penale për veprën penale të Vjedhjes Grabitqare.....	40

IV KAPITULLI I KATËRT

4. Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprave penale të Grabitjes dhe Vjedhjes grabitqare	
4.1 Faktorët Objektiv	45
4.1.1 Ndikimi i krizave ekonomike.....	46
4.1.2 Papunësia.....	48
4.1.3 Jetesa në kushtet e vështira.....	50
4.1.4 Alkoolizmi dhe Narkomania.....	51
4.2 Faktorët Subjektiv.....	57
4.2.1 Vetitë psikike të personalitetit të kryersve të veprave penale të Grabitjes dhe Vjedhjes grabitqare.....	58
4.2.2 Zhvillimi dhe niveli i intelgjencës të kryersve të vprave penale Grabitja dhe Vjedhja grabitqare.....	59
4.2.3 Qëllimet dhe motivet e kryersve të veprave penale Grabitja dhe Vjedhja grabitqare.....	60
4.2.4 Çregullimet mentale.....	62

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

BIBLIOGRAFIA

Hyrje

Njeriu si pjesë e shoqërisë dhe shtetit, kalon nëpër faza të ndryshme të jetës, ndërmerë një sërë vperimesh vetëm që të arrijë një gradë sa më të lartë sigurie, dhe mbrojtje të interesave dhe vlerave të tijë, të cilat në të njejtën kohë janë të cënuara nga ana e kryerësve me veprime të kundërligjshme në përgjithësi me anë të vjedhjes e në veçanti për temën që do flas në vazhdim Grabitjen-neni.237 nga K.P.M dhe Vjedhjen grabitqare-neni.238 nga K.P.M.

Veprat penale kundër pasurisë janë një dukuri, mjaft komplekse dhe problematike e cila njihet si një ndër format më të vjetra të kriminit sa edhe vetë njerëzimi. E njetja vazhdon të jetë aktuale edhe në ditët e sodit.

K.P.M dallon disa lloje të veprave penale kundër pasurisë ndër to edhe Grabitjen dhe Vjedhjen Grabitqare si vepra penale të përbëra tek të cilat kombinohet vjedhja me përdorimin e dhunës-forcës. Duke marrë parasyshë fenomenin e vjedhjes që shfaqet shumë shpesh dhe në forma të ndryshme, duke përfshirë edhe qytetin e Gostivarit më motivoi që të përcaktohem në analizën e kësaj vepre penale.

Prona, gjatë gjithë historisë ka qenë gjithmonë kategorija e veprave penale më tërheqëse për të gjithë shkelësit dhe kriminelët, të cilët tentojnë në çdo kohë, dhe mënyrë me veprimet e tyre kriminale tua rrezikojnë pronat e huaja, me qëllimin e vetëm që tju sjellë dobi pasurore. Prona është e garantuar edhe me Kushtetutë siç theksohet në nenin 30 të Kushtetutës të R.M-së; askujt nuk mund t'i merret ose t'i kufizohet pronësia dhe të drejtat të cilat rrjedhin prej saj, përveçëse kur kemi të bëjmë me interesin publik të përcaktuar me ligj. Shtrohet pyetja pse vjedhja të jetë kaqë vepër e përhapur?.

Njëri ndër shkaktarët kryesorë mund të themi se bëhet fjalë për influencat globale në ditët e sotme, lidhur me krizat ekonomiko shoqërore, që godasin edhe vendet tona, sjellin vështirësi mjaft të mëdha për familje të tëra në mbarë botën, duke shfaqur fenomenin e luftës për egzistencë. Me këtë problematik po ballafaqohet e gjithë bota e cila çdo ditë shkon në rritje. Sa i përket vjedhjes në kohët e sotme ajo është bërë edhe më e vështire pasi që me rritjen e teknologjisë edhe mënyra e kryerjes është bërë më e avansuar në krahasim se në kohët e lashta, gjë e cila po ua vështirëson punën edhe organeve kompetente, mirëpo duhet cekur se edhe organet në fjalë me zhvillimin e teknologjisë kanë më shumë preventiva për ndalimin e vjedhjeve ne përgjithësi. Andaj shpresoj që përmes temës Grabitja dhe Vjedhja grabitqare do të jap mjaftueshëm të dhëna për opinion me shpresë që do të ndikojë edhe në vetëdijësimin e popullatës dhe shpresoj të jap një kontribut në parandalimin këtij fenomeni kaq të përhapur. Ky punim do të përpilohet në bazë të disave metodave shkencorë si përshembull:

- (1) METODA STATISTIKORE** - me anë të së cilës do të mundohem të mledh të dhena nga organet kompetente për veprat Grabitja dhe Vjedhja Grabitqare në Gjykatën e Gostivarit për periudhën 2010-2016, nga Ministira e Punëve të Mbrendshme, dhe Prokuroria Publike, si dhe eni statistikor i R.M.
- (2) METODA KRAHASUESE** - me anë të se cilës do bëhet krahasimi i të dhënave të disponuara nga ana e organeve kompetente, si dhe krahasimin e legjislacioneve penale të Republikës së Kosovës, dhe Republikës së Shqipërisë.
- (3) METODA E ANKETIMIT DHE INTERVISTËS** - e cila të zhvillohet me persona zyrtar: Avokat, Prokuror Publik, Psikolog, Edukator, si dhe me përfaqësues të enteve ndëshkuese-përmirësuese, poashtu edhe me personat e dënuar për kryerjen e veprave penale Grabitje dhe Vjedhje Grabitqare.
- (4) METODA E OBSERVIMIT DHE VROJTIMIT** - me anë të së cilës nxiren në pah vetitë dhe cilesitë e kryerësve të veprave të kundërligjësme. Ky studimi kaq i përhapur dhe aktual do të bazohet, në metodat e sipërmendura, poashtu do bazohet në hulumtimin e shkaqeve të cilat janë faktorë kryesorë në kryerjen e veprave penale Grabitje dhe Vjedhje Grabitqare, ky punim masteri ka për qëllim që të hulumtojë dallimet mes dy formave shumë të rëndësishme të krimeve kundër pasurisë edhe atë: Grabitjes dhe Vjedhjes Grabitqare. Bëhet fjalë për dy vepra penale të përbëra të cilat i quajmë të drejta sepse përmbajnë dy veprime që duhet të realizohen në menyrë kumulative: përdorimi i dhunës, dhe vjedhja, këto vepra të përbëra i quajmë të drejta. Pasi të dy veprimet veç e veç janë vepra penale këto vepra të përbëra i quajmë të drejta përkundër veprave penale të përbëra, jo të drejta ku vetëm njëri nga veprimet paraqet vepër të veçantë penale.

Me anë të punimit në fjalë poashtu do të fokusohemi edhe në mënyrat më efikase për parandalimin e së njejtës. Rëndësi do ti kushtohet edhe sanksionve penale të cilat shqiptohen për kryerësit e veprave penale Grabitje dhe Vjedhje grabitqare. Ky punim ka rëndësi të madhe përshkak se do të ketë një kontribut të rëndësishëm në analizimin e natyrës së Grabitjes dhe Vjedhjes grabitqare. Përshkak faktit që të dy këto forma të veprës penale përfshijnë edhe përdorimin e dhunës krahas vjedhjes, me inkriminimin e tyre mbrohen dy të mira juridike: e drejta e pronës dhe siguria e qytetarëve.

I KAPITULLI I PARË

1.VËSHTRIMI HISTORIKO-JURDIK I VEPRAVE PENALE GRABITJE DHE VJEDHJE GRABITQARE

1.1 Zhvillimi historik-juridik për veprat penale Grabitje dhe Vjedhje grabitqare

Veprat penale kundër pasurisë janë një dukuri mjaft komplekse dhe problematike të cilat njihen si një ndër format më të vjetra të njerëzimit, e njejtë vazhdon të jetë aktuale edhe ditët e sodit. Këto vepra bëjnë pjesë në kriminalitetin klasik, mirëpo kjo nuk do të thotë se format e paraqitjes së krimeve kundër pasurisë nuk kanë pësuar ndryshime dhe se nuk janë lajmëruar forma të reja. Me vepra penale kundër pasurisë nënkuptohen ato vepra penale që shfaqen në marrjen e sendit të huaj me qëllim përfitimi material për vete ose në dobi të personave tjerë ose në dëmtimin apo shkatërrimin e tyre¹.

Sa i përket zhvillimit historik – juridik të veprave penale Grabitje, dhe Vjedhje grabitqare, është me rëndësi të flitet për evoluimin e tyre në : Periudhën e lashtë të së Drejtës Romake, dhe në të Drejtën Zakonore Shqipëtare.

(a) PERIUDHA E LASHTË ROMAKE - Në të drejtën Antike dhe atë Romake pasuria në përgjithësi, prona në veçanti ka qenë e ndarë në pronë private, dhe publike. Prona ishte e përbashkët përshembull njëri ka pasur pronën tjetri veglën e kështu me radhë, e gjithë kjo sepse në atë kohë ishte niveli i ulët i veglave të prodhimit dhe kështu ishte i domosdoshëm bashkëpunimi në mes më shumë personave gjatë procesit të prodhimit, në këtë mënyrë procesi i prodhimit dhe bashkëpunimit ishte i barabartë, dhe pasuria konsiderohej si e përbashkët. Për sa i përket mardhënjeve regullat për regullimin e mardhënjeve pronësore-pasurore nuk ishin të natyrës juridike por natyrës zakonore, për arsye se akoma nuk ishte zhvilluar e drejta që nëkuptonë se regullat udhëhiqeshin nga fiset apo familjet. Me kalimin e kohës filloi edhe zhvillimi rritja e veglave të punës e cila solli deri në uljen e bashkëpunimit domethënë nga më shumë bashkëpunues që ishin më parë erdhi deri te zvogëlimi i bashkëpunuesve, të cilet filluan të minimizohen dhe të ndahen në grupe me një fjalë filloi konkurenca filluan edhe vjedhjet të cilat sollën deri në konflikte të ndryshme. Në këtë menyrë në Romë prona filloi të humbas rëndësinë shoqërore. Kjo ishte faza e parë e fillimit të krijimit të pasurisë apo pronës nga ajo shoqërore në private. Në këtë fazë të zhvillimit shoqëria Romake ishte në kohën e periodës së demarkacionit ushtarak në të njejtën fazë u bë ardhja e një numri të madh të banorëve që skishin jetuar më parë, ku ca prej tyre ishin më të pasur me pasuri gjë që solli konflikte të tjera. Konfliktet sa vinin e rriteshin, nuk mundeshin që akoma të zgjidhen me anë të së drejtës zakonore me çrast erdhi deri te krijimi i regullave të reja të udhëhequra

¹ Ismail Zejneli, E drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Tetovë 2007, fq.111-112

nga persona të pasur gjë që solli përsëri në mospajtim mes shtresës së pasur dhe të varfër².

Këto konflikte të cilat nuk mund të evitoheshin nga e drejta zakonore, sollën deri në krijimin e së drejtës pasurore, apo pronës. Si vepra penale kundër pasurisë-pronës në të drejtën Romake sipas institucioneve të Gait janë: Vjedhje, Grabitja, dhe Iniuria (cënimet e vlerave personale)³.

Pasi që ky punim ka të bëjë me Grabitjen dhe Vjedhjen grabitqare si vepra penale përbërëse të Vjedhjes ne do flasim për Grabitjen dhe Vjedhjen pasi që Vjedhja Grabitqare nuk është e paraparë. **GRBITJA** - Sipas Terenc Lukul është marrja e sendeve të huaja me përodrimin e armëve, forcës, dhe dhunës. Dënimi për këtë vepër për fajtorin ishte sa katërfishi i vlerës së sendit të marrë, apo dëmtuar. Karakteristikë e kësaj vepre është se nëse padia ngrihej brenda një viti atëherë fajtori paguan katërfishin, nëse ngrihet pas këtij afati atëherë paguhet në proporcion me sendin e marrë⁴.

VJEDHJA - Sipas dispozitave të Ligjit XII Tabelave me vjedhje nënkuptohet përvetësimi i ndonjë sendi mirëpo jo në mënyrë të dhunshme. Juristi Paul e përkufizonte vjedhjen si "përvetësim të ndonjë sendi me anë të mashtrimit me qëllim për të siguruar dobi pasurore nga vetë sendi apo nga përodimi ose posedimi i tij". Objekti i sulmit mund të ishte pasuria e luajtshme e tjetrit ndërsa qëllimi ishte dobia pasurore, për sa i përket llojeve të vjedhjes të njohura ishin dy edhe atë vjedhje publike dhe vjedhje e fshehtë. **VJEDHJE PUBLIKE** - ishte çdo sulm që është kapur nga pronari në momentin e marrjes së sendit apo më vonë. Pronari kishte të drejtë ta vriste nëse vjedhja bëhej natën ndërsa ditën kishte drejtë ta vriste nëse i kërcënohej me ndonjë armë. **VJEDHJE E FSHEHTË** - ishte marrja e pasurisë në mënyrë të fshehtë pa u zënë. Në të dyja rastet sipas Ligjit XII Tabelave dënimi ishte pagimi trefish i vlerës së marrë⁵.

² Asllan Bilalli, Bedri Bahtiri, E Drejta Romake, Prishtinë 2015, fq.278-279

³ Ivo Puhan, E Drejta Romake, Tiranë 2007, fq. 370-373

⁴ Ken Dhima, E drejta Romake, Tiranë 2007, fq.682

⁵ Po aty për më gjerësishtë shih ligjin e dymbëdhjetë tabelave nga fq 682-86.

1.2 EVOLUIMI HISTORIK HISTORIK I VPERIMEVE KUNDËRLIGJORE

PERIUDHA E LASHTË - në këtë periudhë dënimi kryhej nga vet personi i dëmtuar apo nga familjarët e të dëmtuarit, dënimet kryheshin në forma publike, poashtu ishte i paraparë edhe dënimi me vdekje të cilën e egzekutojshin gjithashtu familjarët e të dëmtuarit. Vepra penale e vjedhjes dënohej me dënime trupore, që të zbatoheshin e njëjta duhet që personi të zihet në flagrancë. Të gjitha këto veprime të kundërligjshme ndiqeshin me padi private.

- I. **PERIUDHA PARAKLASIKE DHE KLASIKE** - me kalimin në këtë periudhë ndodhi ndryshim për sa i përket veprës së vjedhjes, vjedhja më nuk dënohej me dënime trupore, po u zëvendësua me dënim me të holla e gjithë kjo erdhi për arsye që të bëhet pajtimi mes kryerësit dhe dëmtuarit, domethënë si tip ndërmjetësimi. Në këtë rast erdhi në zbatim Ligji i XII Tabelave, ligj që kishte për qëllim dënime më të buta. Edhe në këtë periudhë veprimet të kundërligjshme ndiqeshin me padi private.
- II. **PERIUDHA POSTKLASIKE** - në këtë kohë ishte tendenca e unifikimit të së drejtës Romake, këtë unifikim e bëri Justinjano që ishte dhe perandori i fundit shekV. Ai bëri kodifikimin e drejtës në fjalë në përgjithësi me ndihmën e juristve profesionist, shkencëtarve nga historia etj. Qëllimi i kodifikimit të drejtës së latëpërmendur ishte krijimi i një sistemi unik juridik për shtetin Romak dhe kthimin e sigurisë juridike për qytetarët Romak. Kodifikimi përmbante libra të ndryshëm por pasi që ky punim ka të bëjë me drejtësinë ne do flasim pikërisht për librat e drejtësisë. Librat e drejtësisë të Justinianit ishin dedikuar Romakëve në përgjithësi e në veçanti ua kishte dedikuar rinisë me titullin "Rinia e etshme për drejtësi", në këtë periudhë filloi lulzimi i drejtës penale, poashtu në këtë periudhë erdhi edhe publikimi i kodifikimit të Justinianit⁶.

Përderisa jemi duke folur për zhvillimin historik të veprave në fjalë është me rëndësi të flitet edhe për paraqitjen e dënimeve me burg si dhe burgjet e para. Dënimet me burg kanë pasur një histori të gjatë, duke kaluar nëpër rrugë interesante evolutive reth zhvillimit dhe transformimit. Burgosja e njerëzve është njohur që në kohët e vjetra, burimet historike flasin se e drejta e shteteve të lashta si e drejta Kineze, Asirase, Egjiptase, Greke, Romake dhe disa të drejta tjera e kanë njohur burgun. Këto burgje kanë qenë të vendosura në kështjellat e vjetëra "Bastilles" ose bodrumet e kalave "Qubliettes" sa i përket kushteve të qëndrimit kanë qenë shumë të vështira. Në këto burgje qëndronin vjedhësit dhe bredhësit. Në Romën e vjetër ka qenë burgu i njohur me emrin "Tullanium" qëllimi i këti burgimi-paraburgimi ishte si sigures që kryerësi të mos ikte deri sa ti shqiptohesh dënimi. Si dënime më të shpeshta ishin dënimet: trupore, me vdekje, dhe me gjobë. Për karakterin e burgut në këtë kohë është interesante mendimi i juristit Romak Ulpian me shprehjen e tij: "Burgjet duhet të përdoren vetëm për mbajtjen e të dënuarve jo të ndëshkohen". Kjo shprehje e

⁶ Po aty, Tiranë 2007.fq.678-680

Ulpianit reth burgit është praktikuar deri në shekullin XVIII përkatësisht deri në paraqitjen e dënimit me burg në Kodin Penal Francez.⁷

Gjatë shekujve XVI-XVIII në shumë vende të botës ndodhi një lëvizje e madhe e popullsisë, gjë që solli deri në shtimin e banorëve e cila pësoi në rritjen e papunësisë, shtimin e endacakëve, vjedhëseve shtim i cili solli rrezik për shoqërinë. Kështu që shtetet morën masa për pengimin e kësaj dukurie u propozua themelimi i institucioneve të veçanta për mbajtjen e këtyre personave me qëllim që të fitojnë shprehi pune. Si institucion i parë konsiderohej burgu “Bridvell”.

Siç shihet këto burgje që atëherë kanë qenë të karakterit preventiv. Mënyra e sanksionimit në preiudhën e vjetër dhe mesjetës siç cekëm më parë bazohej në dënime trupore, vdekje, dhe me gjobë qëllimi i të cilave ishte hakmarja, por pasi që nuk rezultuan pozitivisht apo mjaftueshëm për luftimin e kriminalitetit, për këtë arsye u paraqiten mendime dhe ideja të reja që të gjindet një rrugë tjetër për luftimin e kriminalitetit. Andaj si rezultat për pengimin e kriminalitetit u dhanë mendime që personi i cili është i privuar me burgim jo vetëm të qëndroj në burg ta paguaj për veprën e bërë (d.m.th kthimi i të keqes me të keqe), por ti jepet ndonjë punë d.m.th brenda në burg, ku krahas vuajtjes së dënimit të merret me ndonjë aktivitet i cili do i ndihmonte që pas daljes nga burgu ta vazhdonte punën që e ka mësuar gjatë vuajtjes së dënimit. Andaj si faktorë kryesorë që kontribuan në paraqitjen e dënimit me burg janë:

- Mendimet dhe idetë humaniste të filozofëve dhe shkollave të ndryshme;
- Kontributi i Revolucionit Francez ;
- Shfrytëzimi i punës së personave të dënuar si fuqi e lirë punëtore⁸.

Dënimi me burg sipas konstatimeve në literaturë për herë të parë është paraparë në Kodin penal Francez v.1792, andaj ne do të flasim në vazhdim vetëm për faktorin e Revolucionit Francez në paraqitjen e dënimit me burg. Revolucioni Francez solli ndërrime rrënjësore të bazës juridike të së drejtë penale dhe sistemit ndëshkues. I njëjti ndikoi në implementimin e një sërë ligjesh, dhe sanksionesh ndër to si : dënime me burgim, si dënime kryesore për një varg veprash të cilat më parë egzekutoheshin me vdekje apo lëndime trupore. Doli në pah parimi i njohur i drejtës penale pra parimi i ligjshmërisë i cili shprehej në regullën “nullum crimen sine lege, nula poene sine lege”, parimi i barazisë së qytetarëve si dhe parimet tjera. Me anë të revolucionit në fjalë jeta e njeriut, të drejtat e qytetarëve fitojnë kualitet të veçantë. Në këtë mënyrë zëvendësohen dënimet me vdekje, torturat fizike, dënimet morale dhe çnjerëzore me dënim me burg⁹.

(b) E DREJTA ZAKONORE SHQIPTARE - Në kohët e lashta nëpër territoret Shqipëtare është aplikuar e drejta zakonore në kuadrin e së cilës edhe e drejta zakonore penale të asaj

⁷ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë 2011, fq.93

⁸ Po aty fq 94

⁹ Po aty , gjithashtu për më tepër shih në faqet 95,96 97 98 99.

kohe. Pjesa më e madhe e drejtës zakonore Shqiptare ishte emërtuar Kanuni i Lekë Dugagjinit dhe Kanunet të tjera.

Sipas këtyre kanuneve veprat penale ishin: veprat penale kundër personit, kundër familjes dhe martesës, kundër kishës, kundër pronës private, si dhe vepra të tjera penale¹⁰.

Në shoqëritë e paorganizuara nuk kishte shtet andaj dënimet në atë kohë ndaj kryerësve i aplikonte familja si dënime njiheshin: dëbimi, hakmarja, gjakmarja, shpagimi etj. Në periudhën e mesjetës në trojet në fjalë janë praktikuar ligjet e: Perandorisë Osmane, Sheriati, dhe e Drejta Zakonore Shqipëtare dhe Kanunet¹¹.

EDREJTA ZAKONORE SIPAS KANUNIT TË LEKË DUGAGJINIT - fjala kanun rrjedh nga fjala Greke që do të thotë regull, ky Kanun në vete përmbante përmbledhjen e regullave dhe zakoneve të grumbulluara nga princi i Dugagjinëve Lekë Dugagjini. Kanuni kishte për qëllim regullimin e mardhënjeve në mes shqipëtarëve. Kanuni në fjalë i parashifte këto dënime: gjakmarrje, dënimin me vdekje, dëbimin, djegien e shtëpisë, rrënimin e pasurisë, prerjen e pemëve dhe të lënët e tokës djerrë, gjobën dhe lëçitjen. Kanuni kishte karakter klasor ngase rëndësi të madhe i kushtonte: pronës private, kishës dhe klasës feudale, sipas këtij Kanuni vepra penale kundër pronës ishin: vjedhja, grabitja e prerja, blerja e sendeve të vjedhura, shkatërrimi, dëmtimi i pasurisë së tjetrit¹².

Vjedhja - sipas K.L.D me vjedhje kuptohet marrja pa të drejtë në mënyrë të hapët ose të fshehtë, e pasurisë së tjetrit për të nxjer përfitime materiale. Normat e Kanunit në rastin e vjedhjes nuk i jepnin shumë rëndësi se si është kryer vjedhja, por atyre që sot u jep rëndësi e drejta penale e i quan elementet e anës objektive d.m.th kohës dhe vendit.

Tek kryerja e vjedhjes karakteristike ishte se në rast kur kryhej nga burri nuk ishte e nejtë me kryerjen e vjedhjes nga ana e gruas, kur vjedhja realizohej nga gruaja katundi opinioni e quante turp të madh për familjen e burrit dhe prindërve të saj, thuhet se në fshatrat e Kurveleshit gruaja e cila zihej duke vjedhur e hipnin në gomar dhe e shëtisnin nëpër fshat që ta poshtëronin.

Gabitja - sipas K.L.D jepet ky përkufizim: kur krimi kryhet atypëraty me përdorimin e dhunës dhe forcës, për të marrë sendin e tjetrit. Këta dy elemente pra forca dhe dhuna e dallojnë grabitjen nga vjedhja sipas K.L.D. dënimi për grabitjen ishte përveç kthimit të sendit të marrë edhe me 500 grosh gjobë¹³.

Regullat e kanunit edhe sot e kësaj dite kanë ndikim nëpër disa troje shqiptare si p.sh që cekëm më lartë hakmarja gjakmarja të cilat janë prezente edhe ditët e sodit.

¹⁰ Salihu Ismet, Hasani Fejzullah dhe Zhitia Hilmi, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH Komentari i Kodit Penal i Kosovës, Prishtinë 2014, fq.31;

¹¹ Salihu, Ismet e Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2003, fq.70-72;

¹² Shtjefen Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë 1999, neni 113, paragrafet, 777-781.

¹³ Ismet Elezi, E drejta Zakonore Penale e Shqipëtarëve dhe lufta për zhdukjen e mbeturinave të saj në Shqipëri, Tiranë 1983, fq241-248.

1.2 Ndryshimet dhe sfidat e shekullit XXI për veprat penale Grabitja dhe Vjedhja grabitqare

Miratimi i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë në vitin 1996 ishte faza e parë e reformës së drejtës penale materiale të Maqedonisë, e cila kishte për qëllim të krijojë një sistem të ri vlerash të bazuara në përfitimet demokratike, të sundimit të së drejtës si dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut¹⁴.

Nga miratimi i K.P.M, Kodi Penal në fjalë është ndryshuar disa herë me ndryshime dhe shtesa të pjesëshme ku ndër to përfshihej edhe vepra penale e Grabitjes dhe Vjedhjes grabitqare. Me ndryshimin e K.P.M në tetorë 2008 dënimet për veprat penale Grabitje dhe Vjedhje grabitqare u ashpërsuan, përshkak së numri i këtyre veprave ishte në rritje konstante ,dhe përshkak të rritjes së shakllës së rezykshmërisë shoqërore¹⁵.

Për veprën penale të Grabitjes në Kodin penal të mëparshëm të Republikës së Maqedonisë, dënimi i paraparë për veprën në fjalë ishte e sanksionuar deri në një vjet burg, sanksion i cili më pas pësoi ndryshim me dënim me burgim deri në pesë vjetë¹⁶.

Me novelën e Kodit Penal të vitit 2009 u bënë shumë ndryshime në kapitullin dedikuar inkriminive pasurore, pra veprave penale kundër pasurisë. Gjithashtu për Grabitjen dhe Vjedhjen grabitqare u parapanë dënime më të lehta përshembull në rastet e marrjes së sendeve të luajtshme me vlerë më të vogël. Në lidhje me këtë ndryshim të K.P.M lindën mendime të ndryshme, për arsye se niveli i padrejtësisë edhe në format e privileguara mbetet i njejtë. Edhe pse janë të përmbushura që të dy elementet dhuna dhe kanosja, vetëm fakti se objekt i kryerjes së veprës penale Grabitje apo Vjedhje grabitqare janë sendet me vlerë më të vogël dënimi ishte paraprë nga 1 deri në 5 vjet burg. Ky ndryshim të le përshtypje se mbrojtja e pasurisë (pronës) klasifikohet në një gradë më të lartë se sa mbrojtja e integritetit dhe të drejtave të njeriut. Me ndryshimet e K.P.M me 13 prill të 2011 është bërë precizimi i formave të privileguara dhe kualifikuara të veprave Grabitja dhe Vjedhja Grabitqare¹⁷.

Që të gjitha këto ndryshime në K.P.M janë bërë për qëllimin e vetëm, dhe atë që të gjendet një zgjidhje për luftën kundër krimit në përgjithësi e në veçanti për veprat penale kundër pasurisë me theksë të veçantë për Grabitjen dhe Vjedhjen Grabitqare.

¹⁴ R.M.Ministria e drejtësisë, Strategjija e reformave në të drejtën penale Shkup,2007.fq.70

¹⁵ Ligji për ndryshim dhe plotësim i KPM "Gazeta zyrtare e R.M.nr139 prej 04.11.2008

¹⁶ Ligji për ndryshim dhe plotësim i KPM "Gazeta zyrtare e R.M.nr114/09

¹⁷ Ligji për ndryshim dhe plotësim i KPM "Gazeta zyrtare e R.M.nr 51

II KAPITULLI I DYTË

2.1 Nocioni dhe kuptimi i veprës penale të Grabitjes

Para se të përkufizojmë veprën penale të Grabitjes së pari njëherë duhet të flitet për veprat penale kundër pasurisë në përgjithësi. Veprat penale kundër pasurisë përbëjnë një nga kapitujt më të rëndësishëm të pjesës së posaçme, me veprat penale kundër pasurisë nënkuptojmë të gjitha veprimet që çenojnë dhe rrezikojnë pasurinë private dhe shtetërore¹⁸.

Mbrojtja e të drejtave të pronës së qytetarëve të R.M është e mbrojtur dhe e garantuar me Kushtetutë. Në nenin 30 të Kushtetutës potencohet: “Askujt nuk mund t'i merret ose t'i kufizohet pronësia dhe të drejtat të cilat rrjedhin prej saj, përveç se kur kemi të bëjmë me interesin publik të përcaktuar me ligj. Sipas Kushtetutës pronësia krijon të drejta, dhe obligime dhe duhet të shërbejë për të mirën e individit dhe të bashkësisë, të gjitha llojet e pronës gëzojnë mbrojtje të barabartë me ligj¹⁹.”

Karakteristikë e veprave penale kundër pasurisë është se kanë për qëllim marrjen e sendit të huaj në mënyrë të kundërligjshme, në bazë të literaturave dhe jursitëve të ndryshëm recidivizmi të këto vepra penale është i lartë.

Grabitja - Nënkupton marrjen e sendeve të luajtshme, të cilat përmbajnë vlera pasurore, mënyra e marrjes kryhet në mënyrë të kundërligjshme nga një person tjetër, për realizimin e veprës në fjale veprimi kryhet me ndihmën e forcës ose kanosjes. V.P e grabitjes është gjithmone vepër më rëndë se sa vjedhja për nga shkalla e rrezikshmërisë, vepra konsiderohet si e kryer në moment kur prona në mënyrë të jashtëligjshme kalon tek kryerësi me përdorimin e forcës apo kanosjes.²⁰

Lidhur me fajësin kjo vepër kryhet me dashje, madje në shumicën e rasteve me dashje direkte. Veprimet me anë të së cilave realizohet kjo vepër janë veprime të kundërligjshme të cilat në të drejtat e gjitha shteteve dënohen.

Vepra penale e Grabitjes është vepër penale komplekse e përbër nga dy veprime të jashtëligjshme edhe atë: nga forca (dhuna) dhe vjedhja²¹. Me veprën e Grabitjes çënohen dy vlera më të rëndësishme në jetën e njeriut nga njëra anë liria dhe të drejtat e njeriut dhe nga ana tjetër pasuria. Përshkakë cënimit të këtyre vlerave që janë elementare për njeriun kjo vepër është vepër penale e përbërë. Që V.P e Grabitjes të konsiderohet si vepër penale duhet që të egzistoj lidhshmëria e dy verpimeve të kundërligjshme. Për egzistimin e kësaj

¹⁸ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq.205

¹⁹ Neni 30, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e RMnr.52/91

²⁰ <https://legal-dictionary.thefreedictionary.com/robbery>

²¹ Vllado Kambovski ,Nikolla Trupançevski Edrejta Penale Pjesa e Posaçme,Shkup 2011, fq.293

V.P nuk është me rëndësi se personit që i është marrë sendi është apo nuk është pronar por rëndësi ka që sendi të jetë i huaj që nënkuptonë se kryerësi në atë send nuk ka të drejtë²².

V.P e Grabitjes poashtu mundet të kryhet edhe në bashkëpunim psh: njëri nga kryerësit e përdorë dhunën ndërsa tjetri e merr sendin në këtë rastë kemi të bëjmë me bashkëpunim në kryerjen e VP të Grabitjes.

2.2 Emërtimi ligjor i veprës penale të Grabitjes sipas K.P.M

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë veprën penale të Grabitjes e përkufizon:

“Ai i cili me përdorim të forcës apo kërcënimit së drejtpërdrejtë do të sulmoj ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt, do të marrë ndonjë send të huaj të luajtshëm me qëllim që ta përvetësoj në mënyrë të kundërligjshme,do të dënohet më së paku pesë vjet burgim”.²³

2.3 Elementet që e përbëjnë figurën e vepres penale të Grabitjes

Vepra penale e Grabitjes është vepër penale e përbër nga dy elemente: nga forca, dhe nga vjedhja. Forca në vete përmban poashtu dy elemente: dhunën, dhe kanosjen.

Forca - Ky është elementi me anë të së cilës plotësohet V.P.G, forca si element i V.P.G duhet të jetë e intenzitetit të lartë me qëllim që të parandaloj çdo kundërveprim të personit i cili e posedon sendin dhe ndaj të cilit merret sendi, ose personit i cili mundohet ta ndaloj marrjen e së njejtës²⁴.

Për dallim nga Vjedhja grabitqare në V.P Grabitje forca është mjet për marrjen e sendit dhe kryhet para ose gjatë marrjes së sendit, përdorimi i forcës në V.P Grabitja janë të drejtuar kundër personit, jo kundër sendit. Grabitja me forcë koinçidon (përkon) me marrjen e sendit, gjegjësishtë ndodh në të njejtën kohë dhe hapsirë, pra është mënyrë e marrjes. Përveç saj forca është drejtuar personit që ka sendin në pronësi dhe ka për qëllim pengimin e rezistencës efektive ose potenciale të pronës psh në rastin (kur kryerësi prezantohet rrejshëm si policë dhe të dëmtuarit i vë prangat).²⁵

Dhuna - është forma e parë e forcës si mjet për marrjen e sendit të huaj të luajtshëm. Përdorimi i dhunës nënkuptonë ku kryerësi përdorë forcë fizike ndaj ndonjë personi tjetër me qëllim të ta merr sendin e huaj të luajtshëm. Përdorimi i dhunës nuk është i domosdoshëm që të shkaktojë edhe pasoja, mjafton që të mundësoj të merret pasuria e tjetrit. Dhuna kryesishtë i drejtohet personit nga i cili merret sendi i luajtshëm, mirëpo mundet të drejtohet edhe ndaj ndonjë personi tjetër, në rast kur personi në fjalë paraqet pengesë për marrjen e sendit të luajtshëm, e ndalon ose dëshiron që ta ndaloj në marrjen e

²² Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Deutsche Gesellschaft für Ineternationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Komentari i Kodit Penal të Kosovës, Prishtinë 2014, fq.914

²³ Afrim Osmani, KPM, Shkup 2015, fq.198

²⁴ Илија Симић,Кривични законик-практична примена, Службени гласник, Београд 2007, стр.256.

²⁵ Vllado Kambovski, Komentari i KPM, Shkup 2011, fq.921

sendit. Psh "në rast ku kalimtari i rastit vendos që ti vihet në ndihmë personit ndaj të cilit merret sendi"²⁶.

Kanosja - është në zotërim të kryerësit dhe mvaret në atë se viktimë a do të veprojë në bazë të dëshirës së kryerësit. Kanosja është lajmërim ose paralajmërim e ndonjë të keqje ndaj personit tjetër (viktims). Kjo e keqe në këtë rast është sulmi ndaj jetës ose integritetit fizik. Kanosja në shumicën e rasteve realizohet me anë të armëve, rast i cili na paraqet V.P.G të kualifikuar psh" rasti kur kryerësi me armë në dorë futet në shitore dhe e detyron shitësin që tja ep të gjitha paratë dhe ti bindet në vazhdimësi urdhërave të tij, dhe që të hesht d.m.th mos të lajmërojë policinë". Si kryerës të kësaj veprë mundet që të jet çdo person, poashtu kjo vepër kryhet me vetëdije pasi që kryerësi është i vetëdijshëm për veprën që po e bën, për tu konsideruar se egziston kanosja duhet që ai që kanoset edhe ta shkaktojë të keqen, kanosja duhet të jetë serioze dhe e paevitueshme.²⁷

Vjedhja - duke përdorur forcën për marrjen e sendit të huaj të luajtshëm prrinë elementi tjetër i V.P Grabitje ajo është vjedhja. Me anë të vjedhjes vepra penale në fjalë përmbush të dy elementet që e kategorizojnë të njëjtën si V.P.G.

Vjedhja mundet të jetë e rëndë, ose e lehtë. Objekt i vjedhjes janë sendet e luajtshme, andaj konsiderohet se nuk ka grabitje nëse forca është ndërmarrë nga ndonjë qëllim tjetër d.m.th kur kryerësi e shfrytëzon pa fuqinë e viktims për të kryer vjedhjen, forca dhe vjedhja duhet të qëndrojnë çdoherë në raportë me mjetet dhe me qëllimin. Nuk është grabitje marrja e sendit që i ka rënë viktims gjatë rrahjes. Vepra egziston kur kryerësi e ka marrë sendin ose ka detyruar me forcë të dëmtuarin që ta dorëzojë sendin, ose ta lëshojë drejtpërdrejtë vendin e kryerjes me forcë. Grabitja është kryer me marrjen e sendit kurse tentativa ka të bëjë me fillimin e zbatimit të forcës ose kanosjes.²⁸

Nga kjo që thamë mundë të konkludojmë se në V.P.G forca i paraprinë vjedhjes, ajo në faktë është një mjet për marrjen e sendeve dhe për kërë arsye midis vjedhjes dhe forcës duhet patjetër të egzistojë një lidhshmëri e ndërsjelltë. Nuk mund të ketë një interval të gjatë kohor, sepse forca (dhuna) ndërmiret direkt ose në kohën e marrjes së sendeve.

Në të vërtet në V.P.G bëhet fjalë për dy faza: faza e parë është forca me anë të së cilës kryerësi në vazhdimësi e përdorë për ta arritë objektivin e vet, dhe e dyta vjedhja me anë të së cilës e realizon marrjen e sendit, këto dy fakte me doemos duhet të jenë të përfshira në qëllimin e kryerësit. Kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm që dhunën e përdorë si mjet për të marrë ndonjë send të luajtshëm nga ndonjë person tjetër dhe me çrast kryen vepër penale.

²⁶ Petar Novoselec, E drejta Penale Pjesa e Posaçme, Zagreb 2007, fq.228

²⁷ Po aty fq.229

²⁸ Vllado Kambovski, Nikolla Trupançevski, Edrejta Penale Pjesa e Posaçme, Shkup 2011, fq.294

2.4 Trajtimi i veprës penale të Grabitjes sipas Kodeve penale të (R.Maqedonisë, R.Shqipërisë, R.Kosovës).

2.4.1 Trajtimi i veprës penale të Grabitjes sipas K.P.M

- 1) Ai i cili me përdorim të forcës apo kërcënimit së drejtpërdrejtë do të sulmoj ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt do të marrë ndonjë send të huaj të luajtshëm me qëllim që ta përvetësojë në mënyrë të kundërligjeshme do të dënohet më së paku pesë vjet burgim.
- 2) Nëse vlera e sendit të marrë është me përmasa të mëdha kryerësi do të dënohet me burgim më së paku tetë vjet.
- 3) Nëse vlera e sendit të marrë është më e vogël kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjetë.
- 4) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 ndonjë personit me paramendim i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor, ose nëse vepra është kryerë në përbërje të grupit, bandës apo nëse është përdorur armë zjarri apo mjet i rrezikshëm, kryerësi do të dënohet më së paku dhjetë vjet burgim.
- 5) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 ndonjë personit me paramendim i është marrë jeta, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm²⁹.

a) Nga paragrafi i parë nënkuptojmë se vepra penale e Grabitjes me përdorimin e forcës respektivisht dhunës apo kanojes është mënyra e rëndomtë e kryerjes së kësaj vepre. Pasi që V.P.G karakterizohet nga elementet e lartpërmendura, gjatë kryerjes së njejtës, me anë të dhunës apo kanosjes kryerësi është i vetëdijshëm se rrezikon jetën apo dëmton integritetin fizik të viktimës.

Të gjitha këto veprime kryerësi i realizon me qëllim që ta merr sendin e huaj të luajtshëm për përfitim personal, ose për ndonjë arsye tjetër (ta dëmtoj apo ta shkatërrojë sendin e marrë).

b) Paragrafi i dytë konsiderohet si formë e rendë e V.P.G, nga paragrafi vijues nënkuptojmë se në veprën në fjalë përveç mënyrës së kryerjes së njejtës ligjëvënësi i kushton rëndësi të madhe edhe vlerës së sendit të marrë.

Si vlerë, dobi apo dëm me përmasa të mëdha nënkuptohet dobia, vlera apo dëmi që i përgjigjet shumës së 250 rogave mesatare mujore në RM në kohën e kryerjes së veprës penale³⁰.

²⁹ Afrim Osmani, KPM, Shkup 2015, fq.198

³⁰ Po aty neni 122 paragrafi 36 fq.124

Krahas këtij përcaktimi që e jep ligjvënësi në praktikë kemi raste kur merret ndonjë dokument i cili ka një rëndësi shumë të madhe, madje edhe më shumë se 250 rogat mesatare. Me këtë rast mund të konstatojmë se me vlerë të sendit të marrë nuk duhet shikuar vetëm dobinë pasurore, mirëpo duhet ti kushtohet një vëmendje edhe më e madhe sendeve të cilat në praktikë nuk kanë ndonjë vlerë apo dobi pasurore të madhe, por kanë vlerë të madhe për personin nga i cili merret si psh (marrja e ndonjë dokumenti të vjetër, ose ndonjë dokumenti i cili është faktë apo provë e cila do të jepte një kahje tjetër të ndonjë rasti gjyqësorë, dhe do të ndikonte në zbardhjen e plotë të rastit).

Nga ky shembull nënkuptojmë se dokumenti i marrë nuk ka ndonjë vlerë të madhe pasurore, por për personin nga i cili merret dokumenti ka më shumë vlera se sa çdo pasuri përshkakë se me humbjen e së njetjës do të humbte edhe lirinë e tij e cila është pasuria më e madhe.

c) Paragrafi i tretë llogaritet si formë më e rëndë në krahasim nga paragrafi i parë, dhe më lehtë në krahasim me paragrafin e dytë. Nga ky paragrafë nënkuptojmë se kryerësi me anë të veprimit kundërligjor merr një send të huaj të luajtshëm i cili send sipas ligjëvënsit ka përmasa apo vlerë me të vogël krahasim nga paragrafi nr2.

Si send me dobi, vlerë apo dëm i vogël pasurore nënkuptojmë vlerën dobin apo dëmin që i përgjigjet shumës së një gjysme rroge mesatare mujore e shpallur zyrtarisht në R.M në kohën e kryerjes së vepës penale³¹.

Mirëpo nëse zhytemi më detajisht paragrafit në fjalë në praktikë mund të konstatojmë se për viktimën pak rëndësi ka se çfarë vlere i merret (qoftë me përmasa të vogla apo të mëdhaja) sepse mjafton që vetëm prezenca e kryerësit (hajdutit) i cili viktimës do ti shkaktojë probleme shumë të rënda psiqike probleme të cilat duan shumë kohë të përballohen madje edhe asnjëherë sepse shkaktohet një traum goxha e madhe.

c) Nga paragrafi i katërt nënkuptojmë formën më të rëndë të V.P.G, ku nënkuptojmë se kryerësi përveç forcës, dhunës, kanosjes viktimës i shkakton lëndime të rënda trupore. Në këtë rast kryerësi, kryerjen e veprës në fjalë e kryen e paramendim, gjë e cila në të drejtën penale konsiderohet si veprim më i rëndë i veprës penale.

Me grup, bandë apo organizatë tjetër kriminale nënkuptojmë ku së paku tre persona janë shoqëruar për të kryer vepër penale³². Në mes të grupit dhe krimit të organizuar dallimi është se grup kriminal i organizuar do të thotë grup i strukturuar i cili egziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtë ose tërthorët të dobisë pasurore, ndërsa me grup nënkuptojmë grup prej tre e më shumë personave të cilët janë të lidhur për kryerje të kohë pas koheshme të V.P.G ku secili pjesëtar jep kontributin e vet në kryerjen e V.P, pra nuk

³¹ Po aty paragrafi 33 fq.125

³² Po aty paragrafi 28 fq124

është grup i strukturuar i cili vepron sipas hierarkisë sikurse tek grupi kriminal i organizuar. Kryerja e Grabitjes në përbërje të grupit ose bandës, duke përfshirë armë apo mjete të rrezikshme, është forma më e vaçantë kualifikuese e V.P.G, përshkak se këtu veçohet shkaktimi konkret i rrezikut për jetë ose për trupin nga dy ose më tepër personave në bankë, këmbimore, ose vende publike.³³

d) Nga paragrafi i pestë kuptojmë V.P.G të kualifikuar sepse kryerësi përveç grabitjes ai kryen edhe vrasje me paramendim, bëhet fjalë për V.P.G të rëndë por jo edhe për tentativë.

Tentativa e kësaj vepre penale është e dënueshme. Si rast i kualifikuar i V.P.G në këtë paragraf konsiderohet poashtu në rastet kur kryerësi me dashje i shkakton lëndim të rëndë trupor ose vrasje viktimës edhe nëse vepra në fjalë mbetet në tentativë dmth (nëse sendi nuk është marrur). Tek paragrafi pestë si formë akoma më e kualifikuar konsiderohet kur si pasojë e lëndimeve trupore apo të dhunës së shkaktuar nga kryerësi i cili që ta realizojë qëllimin e vet i shkakton vdekje viktimës, gjithashtu në paragrafin vijues nuk mund të përjashtohet edhe vrasja mizore, e kryerësit ndaj viktimës i cili e kryen këtë mënyrë të vrasjes, për arsye të arritjes së qëllimit. Nëse vrasja është kryer nga pakujdesia atëherë kemi të bëjmë me grabitje dhe vrasje nga pakujdesia³⁴.

2.4.2 Trajtimi i veprës penale të Grabitjes sipas Kodit Penal të R.Shqipërisë

Pasi që Grabitja si vepër penale bën pjesë në veprat penale kundër pasurisë atëherë është me rëndësi njëherë të cekim se si e përkufizon Kodi në fjalë veprat penale kundër pasurisë.

Sipas Kodit Penal të R.Sh-së me veprat penale kundër pasurisë nënkuptojmë vepra penale të kryera kundër personave fizik, juridik dhe të shtetit, të kryera me (veprim ose mosveprim) që shfaqen në marrjen, hedhjen ose kthimin e pasurisë në mënyrë të kundërligjeshme, të kryera me dashje ose me qëllim për të mos e kthyer, për të nxjerë përfitim material për vete ose për ndonjë person tjetër si dhe në shkatërrimin ose dëmtimin e sendit të huaj.³⁵

³³ Vllado Kambovski, Komentari i KPM Shkup 2011, fq 921

Shih edhe neni 122 paragrafin 32 me vend publik nënkuptohen ndërtesat, pjesë të ndërtesave, oborret, objektet për kryerjen të veprimtarisë tregtare, kulturore, zyrtare, arsimore, religjioze, rekreative, rrugë publike, haësira të hapura sipërfaqe ujore dhe vende tjera të hapura dhe të arritshme për një qark të pakufizuar të personave.

³⁴ Po aty fq 923

³⁵ Ismet Elezi, e Drejta Penale Pjesa e Posaçme, Tiranë 2002, fq 155

Në të drejtën penale Shqipëtare veprat penale kundër pasurisë janë:

- a) Veprat penale që kanë të bëjnë me prëvetësimin e pasurisë në pronësi të personave fizikë, juridik, dhe të shtetit; si dhe
- b) Veprat penale të cilat lidhen me shkatëtimin ose dëmtimin e pasurisë³⁶.

Për dallim nga Kodi i R.M-së, Kodi i R.Sh-së veprat penale janë të ndarë në seksione, edhe atë:

- Seksioni I u kushtohet vjedhjes së pronës me të gjitha llojet dhe format e saj.
- Seksioni II u kushtohet Mashtrimeve
- Seksioni III i kushtohet shkatërimit të pasurisë³⁷.

Pasi që ky punim ka të bëjë me V.P.G në vazhdim ne më shumë do të fokusohemi tek seksioni i parë sepse aty e gjejmë atë se çka na intereson më shumë nga kjo temë.

Në seksionin e parë llojet e veprave penale kundër pasurisë janë: Vjedhja, Vjedhja duke shpërdoruar detyrën, Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit, Vjedhja e energjisë elektrike ose e impulseve telefonike, Vjedhja e veprave të artit të kulturës, Vjedhja me dhunë, Vjedhja me armë, Vjedhja me pasojë vdekjen³⁸. Siç po e shofim nga Kodi i Shqipërisë vepra penale e Grabitjes nuk është inkriminuar si vepër penale kundër pasurisë, por nëse shofim më detajisht Vjedhja me dhunë është ajo e cila është e përafërt me V.P.G, pasi që kanë lidhshmëri tek marrja e sendit të huaj ,dhe tek integriteti fizik i personit pra (dhuna).

Grabitja reth viteve 60,70 ka egzistuar si vepër penale edhe në Shqipëri mirëpo me kalimin e kohës veprës penale së Grabitjes i ndryshohet titulli d.m.th në Vjedhje me dhunë. Gjatë një bisedimi me një gjyqëtar (në Gjykatën e Apelit në Durrës), mësova edhe arsyen e asaj se pse V.P.G nuk parashihet më.

Neni 102 i K.P.SH të vitit 1977 përbëhej vetëm nga një paragraf, ku hynin përdorimi i dhunës fizike e deri në vdekjen e personit, dhuna psqike përdorimi i armëve që do të thoshte se gjykata pasojën e rëndë do ta merrte vetëm si rethanë që e rëndonte masën e dënimit, pasi kjo dispozitë ligjore nuk parashikonte kryerjen e veprës penale në rethana të cilësuar në Kodin Penal të viteve 90, V.P.G u shfuqizua dhe u nda në tre vepra penale dhe atë: vjedhja me dhunë, me armë, me pasojë vdekjen.

Qëllimi kryesorë i ligjëvënësit në shpërbërjen e V.P.G ka qenë fakti se kjo dispozitë ligjore nuk parashikonte rastet kur vepra në fjalë kryhej në rethana të cilësuar , dhe kishte

³⁶ I njejt autor po vetëm me botim tjetër 2014 fq.202-203

³⁷ Aleks Nikolli, Kodi penal i R.SH Tiranë 2016, Kreu III, Seksioni I, Vjedhja e pasurisë

³⁸ Po aty nenet 134-141

një ndyshim shumë të madh ndërmjet minimumit dhe maksimumit të masës së dënimit³⁹. Poashtu i njejtë më ndihmoi edhe me disa raste studimi tek vjedhja me pasojë vdekjen pra si formë e kualifikuar e vjedhjes të cilin rast do ta shpjegojmë më vonë.

Vjedhja me dhunë sipas Kodit penal të R.SH-së në nenin 139 përkufizohet: Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjetë⁴⁰.

Sipas kësaj dispozite nëse marrim të bëjmë krahasimin në mes asaj se çka kanë të përbashkët dhe se në çfarë dallojnë mund të konstatojmë se si ngjashmëri i kanë elementet e përbashkëta dmth dhunën apo kanosjen të cilat përdoren në kryerjen e veprës penale nga njëra anë dhe nga tjetra anë sendin e huaj i cili merret për qëllime përfitimi.

Ndërsa dallimi është në atë se në Kodin e Shqipërisë tek vepra penale e Vjedhjes me dhunë nuk përmendet për vlerat e sendit të marrë se janë me përmasa të mëdha apo të vogla siç theksohet në KPM poashtu nuk përmendet kryerja e veprës nga banda apo nga grupi ose krim i organizuar, ndërsa në raste kur si pasojë e vjedhjes me dhunë është shkaktuar vrasja e viktimës atëherë në Kodin Penal të R.SH-së ka dispozit të veçantë në nenin 141 (vjedhja me pasojë vdekjen ku normalisht shihen edhe sanksione më të rënda).

Tek vepra penale e vjedhjes me dhunë është karakteristike se në Kodin penal të R.SH-së dhuna për të mbajtur sendin e marrë mundet të përdoret përpara marrjes së sendit si rasti tek V.P.G sipas K.P.M por mund të përdoret edhe pasi që është marrë sendi p.sh (pronari i sendit kur e sheh kriminelin duke i vjedh sendin tenton që ta ndaloj të njejtin, krimineli për ta mbajtur sendin përdorën dhunë ndaj pronarit dhe e mban sendin e marrë në mënyrë të kundërligjshme) në bazë të kësaj konstatohet se vjedhje me dhunë sipas Kodit përkatës është mikse e V.P.G dhe Vjedhjes grabitqare sipas K.P.M sepse përmban përodrimin e dhunës dmth edhe para marrjes së sendit por edhe pas me çka përodrimi i dhunës pas marrjes së sendit në K.P.M nuk është me V.P.G por Vjedhje grabitqare⁴¹.

Vjedhja me dhunë sipas Kodit në fjalë konsiderohet krim i rëndë i një shkalle të lartë shoqërore sepse siç cekëm çënohet integriteti fizik, dhe pasuria e personit. Sipas Kodit Penal të R.SH-së dhuna mund të jetë dhunë fizike ose psikike (kanosje serioze), për tu konsideruar vjedhje me dhunë duhet që dhuna ti drejtohet personit, në rast se dhuna nuk përdoret aty për aty por është përdorur pas marrjes së pasurisë dhe jo për ta rruajtur atë, atëherë kemi të bëjmë me dy vepra penale: vjedhje, dhe rrahje ose plagosje sipas rrastit. Subjekti i vjedhjes me dhunë mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, vepra penale e Vjedhjes me dhunë kryhet me dashje direkte. Vjedhje me dhunë mund të mbetet edhe sipas Kodit përkatës në tentativë p.sh kur kryerësi

³⁹ I gjithë ky sqarim reth VPG erdhi me anë të ndihmesës së Gjyqtarit të thksuar më larte i cili më ndihmoi me anë të disa aktgjyqimeve të cilat në vete përmbanin edhe sqarime.

⁴⁰ Delo Meçani, e Drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Kometnar i përditësuar me ndryshimet deri në vitin 2017, Nëntor 2017, fq.275

⁴¹ Ismet Elezi, e Drejta Penale, Pjesa e Posaçme Tiranë 2002 fq 155-158

përdorën dhunën por nuk e vjedhë pasurinë, poashtu kodi në fjalë nuk e shikon si rethanë rënduese kryerjen e Vjedhjes me dhunë në bashkëpunim ose në grup po vetëm në raste kur pëson vdekja⁴².

2.4.3 Trajtimi i VPG sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Përkufizimi i nocionit të V.P.G në mes të K.P.M dhe K.P.K mund të konstatojmë se kanë gati se ngjashmëri të madhe, pasi që Kosova ka qenë krahinë Autonome e Federatës së Jugosllavis, ndërsa Maqedonia ka qenë Republikë e Federatës së Jugosllavisë. Andaj për këto dy shtete në kohën e Jugosllavisë ka egzistuar i njejtë sistem juridik. Përderisa në Kodin R.Shqipërisë V.P.G nuk ishte inkriminuar si vepër penale kundër pasurisë në R.Kosovës njejtë si në K.P.M kjo vepër është e inkriminuar, ku në vazhdim do të shpjegojm për V.P.G sipas K.P.K.

Sipas K.P.K të vitit 2003 veprat penale kundër pasurisë janë të përfshira në kapitullin XXIII, dispozitat e parapara në këtë kapitull janë të karakterit konstitiuv, me dy elemente përbërëse edhe atë: *dispozitivi* ku përfshihen nocioni dhe elementet e V.P.G, dhe *sanksioni* ku parashifet lloji dhe lartësia e dënimit. Sipas K.P.K të vitit 2014 se si inkriminohet V.P.G do ti referohemi nenit 329 sipas të cilit vepra në fjalë përkufizohet:

1. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që ti sjell vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjësme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjetë.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me sendin e vjedhur me vlerë që tejkalon pesëmijë Euro, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë deri në dymbëdhjetë vjetë.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë deri në dymbëdhjetë vjetë.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjetë.
5. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej së paku dhjetë vjetë ose burgim të përjetshëm⁴³.

V.P.G njejt si tek Kodet e mëparshme të potencuara mundet që të ngelet në tentativë, veprimi i kryerjes së kësaj vepre poashtu përkonë në marrjen e sendit të huaj me përdorimin e dhunës apo kanosjes, kryerësi i veprës është çdo person i cili është i përgjegjshëm dhe ka

⁴² Po aty fq 277

⁴³ Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Komentari i KPK botimi 2014 fq.913.

mbushur moshën madhore. Është me rëndësi të potencohet se në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2003 tek V.P.G janë paraparë edhe rastet e rënda të së njejtës d.m.th me theks të veçantë të cilat me miratimin e K.P.K në vitin 2012 janë hequr.

Heqja e rasteve të rënda të V.P.G sipas autorëve ka qenë me vend sepse në kodin e vjetër rastet e rënda janë sanksionuar me dispozita të veçanta, këtë e dëshmon edhe praktika gjyqësore se trajtimi gjyqësor i këtyre rasteve ishte paksa më i ndërlikuar, sepse edhe pse ishte fjala për të njejtat vepra penale por si raste të rënda pasi që sanksionimi ishte i veçantë sillte paqartësi në zbatimin e Ligjit.⁴⁴

Në bazë të këtyre përkufizimeve shihet qartë se V.P.G si në K.P.M ashtu edhe në K.P.K janë shumë të ngjashme si dallim mund të shohim mënyrën e sanksioneve.

Në K.P.K në të gjitha paragrafet potencohet dënimi me gjobë (me siguri këtu fjalën ligjëvënësi e ka pasur kur V.P.G kyhet nga pakujdesia), ndërsa në K.P.M e njejtat nuk potencohet, poashtu kur jemi tek sanksionet (dënimet me burg) që u shqiptohen kryerësve në K.P.K janë më të ashpra përveç në rastet kur kemi të bejmë me vdekjen e viktimës e cila konsiderohet si rethanë rënduese tek të dy Kodet, përderisa tek K.P.M paragrafi 2,3 i dedikohet përmasës së sendit të marrë dmth se sendi i marrë është me përmasa të mëdha ose të vogla, në K.P.K në paragrafin 2 i referohet vetëm nëse sendi i marrë e tejkalon 5000 Euron.

Poashtu në bazë të analizës së këtyre dy neneve duhet të potencohet edhe pesha e dënimit, tek V.P.G në K.P.M minimumi i shqiptimit të dënimit parashihet vetëm në paragrafin 3 (nëse sendi i marrë është me përmasa të vogla kryerësi do të dënohet prej një deri në pesë vjet), derisa në K.P.K minimumi i shqiptimit të dënimit nga ligjëvënësi potencohet tek të 4 paragrafet, me përjashtim të paragrafit 5 që janë identike.

Tek Kodi në fjalë mënyra e zbutjes së dënimit parashihet në nenin 67 paragrafi 1 ku theksohet se : nëse për veprën penale është e paraparë si masë me e ulët e dënimit me burgim prej së paku tre vjet, dënimi mund të zbutet deri në një vit⁴⁵. Përderisa K.P.M për veprat penale për të cilat parashihet dënim me burgim prej më së paku një e më shumë vjet, zbutja mund të bëhet deri në tre muaj burgim⁴⁶.

Për sa i përket elementeve që të dy Kodet i kanë të njejtat, d.m.th përfshihen Forca (dhuna apo kanosja), dhe Vjedhja e pasurisë së huaj të luajtshme.

Karakteristikë themelore e veprave penale kundër pasurisë në përgjithësi e në veçanti V.P.G nga të treja Kodet (Maqedoni, Shqipëri, Kosovë), që i elaboruam konstatojmë se janë:

⁴⁴ Deri në fjalimin e thënë erdha në konstatim me një jurist nga qyteti i prizrenit, me ndihmesën nga komunikimi i bërë u konstatua për rastet e rënda të VPG si dhe heqjen e të njejtave.

⁴⁵ Ismet Salihu, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2008, faqe 508

⁴⁶ Vllado Kambovski E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Shkup 2010, faqe 550

- Motivi i kryerjes (që nënkuptonë përfimiti material i kryerësit nga sendi i huaj);
- Dashja (V.P.G në të shumtën e rasteve kryhet me dashje dirkte);
- Dënimet (dënime me burg dhe me gjobë);
- Recedivizmi (në V.P.G recedivizmi nga ana e kryerësve është shumëherë i përsëritur);
- Organizimi i kryerësve (në banda, grupe, apo organizata kriminale);
- Masoviteti (vepra në fjalë ta konsiderojmë si moderne shkaki që shkon në rritje shumë të madhe sidomos në vendet tona).

2.4.5 Shqiptimi i sanksioneve për veprën penale të Grabitjes

Sanksionet penale janë masa ndëshkuese penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata në procedurë të përcaktuar me ligj ndaj kryerësit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, dhe e njëjta konsiston në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara, ose në tërheqjen e vërrejtjes ndaj kryerësit se do ti merren apo kufizohen liritë ose të drejtat nëse përsëri kryen vepër penale.⁴⁷

Nga ky përkufizim mund të kuptojmë elementet e përgjithëshme të sanksionit edhe atë:

- a) Pasojën juridike që paraqitet për kryerësin e V.P;
- b) Masa e detyruar që e shqipton gjyqi;
- c) Sanksioni penalo-juridik që ka të bëjë me marrjen ose kufizimin e disa të drejtave të kryerësit, dhe paralajmërim që kryerësi të mos bëhet recedivist⁴⁸.

Kusht kryesor për shqiptimin e sanksionit është përgjegjësia penale e kryerësit, sanksioni shqiptohet vetëm kur plotësohen kushtet e caktuara me ligj, qëllimi i dënimit me privim nga liria konsiston në mbrojtjen e shoqërisë nga veprat e ardhëshme penale, sanksionet janë detyrime me anë të së cilës sigurohet bindja e qytetarëve para ligjit.

Qëllimi i sanksioneve në përgjithësi ka të bëjë jo me hakmarjen ndaj kryerësit d.m.th kthimi i të keqes me të keqe por qëllimi i sanksionit konsiston në risocilizimin, përmirësimin dhe edukimin e kryerësit, për më gjerësisht në vazhdim reth qëllimit të sanksionit do ti cekim disa teori edhe atë teoritë: absolute dhe relative (në preventimin special, preventimi gjeneral), dhe arritja e drejtësisë.

- 1) **Teoritë absolute**- sipas kësaj teorie qëllimi i dënimit ishte hakmarrja ndaj kryerësve të V.P;
- 2) **Teoritë relative: (Preventiva speciale, gjenerale dhe arritja e drejtësisë);**
 - a) **Preventimi special** - i drejtohet kryerësit të V.P, qëllimi i kësaj preventive ka të bëjë me atë që kryerësi të mos kryej vepër të re penale, preventiva në fjalë realizohet me

⁴⁷ Ismet Salihu, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2012, fq.425

⁴⁸ Vllado Kambovski, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Shkup 2010, fq 447.

anë të frikësimit se në rastë se kryen përsëri V.P do ti merret liria dhe do ti kufizohen disa të drejta.

- b) **Preventimi gjeneral** - qëllimi i kësaj preventive u referohet qytetarëve tjerë që të mos jenë kryerës të V.P. Pra qëllimi i përgjithëm i preventivës gjenerale ka të bëjë me mos kryerjen e V.P të reja nga ana e kryerësve potencial (kryerësve të tjerë): me sanksion nuk e frikësojmë vetëm kryerësin por edhe qytetarët tjerë. Qëllimi i preventivës gjenerale nuk është vetëm frikësimi i qytetarëve por edhe ndikimi edukues dhe përforcimi moral dhe zhvillimi i disiplinës shoqërore të qytetarëve.
- c) Një nga funksionet kryesore të shqiptimit të sanksioneve penale është edhe **arritja e drejtësisë**, kjo d.m.th se mbrojtja e shoqërisë prej kriminaliteti nuk arrihet vetëm nga shkaqet speciale dhe të përgjithëshme por edhe për shkak të drejtësisë nga shkaqet që i lënë vend hakmarjes.⁴⁹

Instrumetet kryesore për realizimin e qëllimive të sanksionit janë: matja gjyqësore e dënimit bazuar mbi parimin e individualizimit të dënimit, vuajtja e dënimit, dhe regjimi i pozitës juridike të të dënuarit pas vuajtjes së dënimit. Sanksionet duhet të jenë në përpjestimë me peshën e veprës dhe me fajin e kryerësit dhe në funksion të preventivës gjenerale. Sistemi i sanksioneve të parapara në K.P.M është i sistemit pluralist sepse përmban: dënime, masa alternative, masa siguroese, dhe edukuese.⁵⁰

Njeriu si krijesë në këtë botë gëzon shumë të drejta si: e drejta e jetesës, e drejta e pronës, e drejta lëvizjes së lirë, e drejta e punës etj, që të gjitha këto të drejta ai që i gëzon mundet që ti merren apo ti kufizohen si pasojë e kryerjes të ndonjë veprë penale ku K.P.M parasheh sanksion, me këtë nënkuptojmë d.m.th një e mirë nga ana e shtetit që mbronë qytetarët, shoqërinë nga kriminaliteti, por nga këndvështrimi tjetër a është shteti ai i cili ndihmon kryerësve në mos kryerjen e V.P d.m.th para se me kryer veprën p.sh rasti konkret në vendin tonë pasi punimi ka të bëjë me VPG dhe VPVG pse ndodhin vjedhjet sepse njerëzit dëshirojnë?.

Nuk e përjashtojmë teorinë e Cezaro Lombrozës për kriminel të lindur por atë se sa shteti u mundëson qytetarëve kushte për të mos kryer V.P psh rasti i shteteve Skandinave kur kriminalitet është në numrë të vogël. Lidhur me këtë del në pah ajo se në një shtet i cili pretendon për të përparuar p.sh shteti ynë , krahas shqiptimi të sanksioneve, duhet të ndërmerre masa të ndryshme p.sh hapjen e fabrikave, rroga të mira, ngritja e nivelit të arsimit, si dhe një numër të madh masash për rritjen e ekonomisë me anë të së cilave mund të konstatojmë që njerëzit nuk do kenin edhe shumë kohë të kryenin për pak e për shumë vepra penale të vjedhjes qoftë Grabitje, Vjedhje grabitqare, ose Vjedhje të rëndomtë .

Para se me i elaboruar të dhënat e marra nga Enti Statistikor i R.M si dhe të dhëna nga Gjykata e Gostivarit me disa raste studimi për V.P.G në fillim njëherë do ti numrojmë

⁴⁹ Afrim Osmani, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve Shkup 2013, fq 64-66

⁵⁰ Vllado Kambovski, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Shkup 2010, fq 459

sanksionet e parapara sipas K.P.M. Sipas Kodit në fjalë janë të parapara këto lloje sanksionesh:

- **Dënimet** (kryesore dhe dënime dytësore).
- **Masat alternative** (dënimi me kusht, dënimi me kusht me mbykqirje mbrojtëse, ndërprerja me kusht e procedurës penale, puna në dobi të përgjithëshme, vërejtje gjyqësore, dhe burg shtëpiak qëllimi i kësaj mase është për vepra penale të vogla të mos shqiptohet dënim por një paralajmërim).
- **Masat sigurose** (mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në insturcionet shëndetësore, mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri, mjekim i detyruar i alkolistëve dhe narkomanëve, kjo mas u shqiptohet kryerësve të papërgjegjshëm ose me përgjegjësi esenciale të zvogëluar).
- **Masat edukuese** (masa disiplinore, masat e mbykqirjes së intensifikuar, masat e enteve).

Në vazhdim do të përqendrohemi më shume tek dënimet si sanksione të K.P.M, pasi që kryerësit e veprave penale të Grabitjes më shumë u shqiptohen sanksioni në fjalë.

A) Dënime kryesore: Dënimi me burg (kryesorë), tek dënimi me burg minimumi është 30 ditë ndërsa maximumi 20 vjet, burgu i përjetshëm alternativa 40 vjetë, nuk i shqiptohet kryerësit më të ri se 21 vjet, Dënimi me gjobë (kryesorë dhe plotësues)

B) Dënime dytësore: Ndalimi i ushtimrimit të profesionit, ndalimi i drejtimit të automjetit, dëbimi i të huajit nga vendi, ndalimi i ndjekjes së ndeshjeve sportive⁵¹.

⁵¹ Njohuri të përgjithshme nga Besa Arifi tek lënda e Penologjiës gjatë studimeve post diplomike, poashtu edhe Ismail Zejnelit tek lenda e Drejta Penale pjesa e përgjithshme bazuar në oret e ligjeratave

Në vazhdim to të nxjerrim edhe tabelen e entit statistikor për V.P kundër pasurisë:

Tabela 1.

Viti kalendarik	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Rastet e paraqitura të veprara kundër pasurisë	19 846	21 956	22 292	24 595	25 745	15 856	12 262
Të akuzuar për VP kundër pasurisë	3 612	3 850	4 263	4 822	4 585	4 863	3 745
Të dënuar	3 612	3 850	3 652	4 073	3 965	4 296	3 370

Të dhena nga enti statistikor i R.M⁵²

Në bazë të kësaj tabele shofim qartë një numër të madh të kryerjes së veprave penale kundër pasurisë, ku numri më i madh i rasteve të paraqitura është viti 2011, 2012, 2013, 2014. Përderisa në vitin 2016 shohin një ulje shumë të madhe. Me anë të tabelës nr 1. Këto që të gjitha janë vetëm raste të paraqitura vlen të ceket se shumica e rastave ngelin vetëm si të paraqitura jo të përfunduara d.m.th që të njihet kryerësi, siç shohim më detajisht numrin e të akuzuarve një numër shumë i vogël i të akuzuarve krahasim nga V.P të paraqitura nga kjo mund të konstatojmë, fatkeqësisht se sa sheti ynë është i gatshëm në luftimin e kriminalitetit.

⁵² <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>

Tabela 2.

Të gjykuarit. Për disa vepra penale kundër pasurisë në vazhdim	Të gjykuar	Femra	Dënim me burg	Dënim me gjobë	Dënime dytësore
Vjedhje	495	48	85	88	0
Vjedhje e rëndë	699	21	368	32	0
Grabitje	44	4	40	0	0

Të dhena nga enti statistikor i R.M⁵³

Në bazë të kësaj tabele numri i Vjedhjes dhe Vjedhjes së rëndë si vepra penale kundër pasurisë është më i përhapur në krahasim me V.P.G, numri më i madh i të gjykuarëve, si dhe shqipimi i dënimit me burg është i aplikuar më shumë në veprën e Vjedhjes së rëndë më pas vjen Vjedhja.

Karakteristikë nga kjo tabelë është se nuk kemi asnjë dënim të shqiptuar sekondarë madje në V.P.G as edhe dënimin me gjobë. Në jetën e përditëshme tek veprat e vjedhjes kemi të njohur se si kryerës të veprave të vjedhjes ne përgjithësi janë meshkujt por në bazë të kësaj tabele atëherë shohim se edhe numri i femrave nuk është i vogël, andaj konstatojmë faktin që më para ka qenë numri i femrave më vogël shkaku i nderit moralit apo frikës nga prindërit, mirëpo me zhvillimin e teknologjisë në një jetë kaq dinamike, të lakmueshme pas gjërave të huaja ku respekti nderri kanë rënë andaj është mjaft normale se edhe femrat do jenë kryerëse.

Sa i përket vjedhjes grabitqare në këtë tabelë se kam paraqit pasi që në kapitullin e tretë do ta sqaroj në mënyrë më të zgjeruar.

⁵³ Po aty

Tabela 3.

Dënimet	Burg i përjetshëm	Burg deri 20 vjet	10-15 vjet	5-10 vjet	3-5 vjet	2-3 vjet	1-2 vjet	6 muaj deri 1 vjet	Deri 6 muaj
V.P Grabitje	0	1	6	15	11	5	1	4	1
Dënimet me gjobë për veprat penale kundër pasurisë	Dënim me gjobë për VPG	Dënime dytësore për VPG							
237	0	0							

Të dhëna nga enti Statistikor i R.M⁵⁴

Nga tabela e tretë për sa i përket sanksionimit shihet se ndaj kryerësve të veprave penale dënimi me burg është më shumë i aplikuar, dënimi me gjobë është shqiptuar në vepra penale kundër pasurisë (më shume tek vjedhja dhe vjedhja e rëndë), por në V.P.G asnjë, poashtu në bazë të hulumtimit nga enti statistikor i R.M për V.P.G nuk kishte të shqiptuar as edhe dënim sekondar. Sa i përket dënimit me burg, dënimi prej 5-10, dhe 3-5 vjet është aplikuar më shumë, ku pastaj mbi sundojnë dënimet nga 1 deri 3 vjet.

Shqiptimin e dënimit me burg dmth maksimumin e paraparë që është 20 vjet kemi vetëm një rast, përderisa dënimi me burg të përjetshëm asnjë.

Nga e gjithë kjo analizë nga tabela e lartpërmendur konstatojmë që në V.P.G kemi raste edhe kur është shqiptuar edhe dënimi me burg të përjetshëm ndaj kryerësve por përshkak të bashkimit të V.P.G dhe vrasjes ato janë treguar nga enti statistikor në V.P të vrasjes d.m.th këtu i referohemi asaj që kemi mësuar në të drejtën penale bashkimi i V.P. p.sh në V.P.G kryerësi kryen dy V.P nga njëra anë V.P.G nga tjetra anë Vrasje andaj në procedurë penale ndaj kyersësit do të zhvillohet një procedurë dhe do të merret një vendim.

Të gjitha këto statistika të lartë përmenduara si burim e kishin entin statistikor të R.M, në vazhdim do të paraqesë tabelën e marrë nga gjykata e Gostivarit për veprën penale të Grabitjes, së bashku me një vendimë gjyqësor, e më pas në kapitullin e ardhshëm për veprën penale të Vjedhjes Grabitqare.

⁵⁴ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>

Tabela 4.

Marrë më datë:27.03.2019

Nga Gjykata e Gostivarit

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Gjithësejt
VPG	6	10	16	8	7	8	2	57

Nga tabela sipër përmendur me të dhënat nga gjykata në fjalë krahas asaj që dëgjojmë për vjedhjet respektivisht Grabitja e cila kryhet me përodrimin e dhunës apo kanosje në rethinën e Gostivarit nga ajo që shofim në tabelë kuptojmë një numër të vogël, në këtë rast poashtu vlen të përmendet edhe numri i errët, raste të jo paraqitura drejt organeve kompetente ose raste të jo zbardhura nga organet në fjalë.

Ti referohemi tablës në bazë të statistikave të marra nga gjykata e Gostivarit shohim se viti 2011 dhe 2012 ka qenë me më shumë kryerje të V.P.G, përderisa në vitet 2010, 2013, 2014, 2015 kemi një mesatare nga 6 deri në 8 vepra të kryera. Sa i përket vitit 2016 shohim një ulje shumë të madhe ku mund të konstatojmë se nuk është si rezultat i organeve kompetente jo se është ndërmarrë, apo zhvilluar ndonjë risi në luftimin e kësaj dukurie por rezultati është emigrimi për një jetë më të mirë apo më konkretisht Gjermania me heqjen e vizave dhe me mundësimin e punësimit në shtetin në fjalë me kontratë pune. Jemi vetë dëshmitar se këto 3 vitet e fundit kemi një emigrim shumë të madhë të të rrinjëve dhe të rrejave nëpër vendet perendimore, gjë e cila sjell në zvogëlimin e popullsisë së jetuarit në shtetin tonë, si dhe në kryerjen e veprës penale të vjedhjes qoftë ajo Vjedhje e rëndomtë, rëndë, Grabitje etj.

Sa i përket llojit të sanksioneve të shqiptuara për V.P.G nga gjykata në fjalë nuk mu mundësua që ti marrë të gjitha (për 57 vepra penale të Grabitjes), por do ti përmendë disa sanksione të shqiptuara të marra nga një bisedim me një gjyqëtar, dhe avokat që punojnë në Gjykatën e Gostivarit.

Si sanksione më të shqiptuara për VPG në gjykatën në fjalë janë:

1. Dënimi me burg (nga dënime të ndryshme disa janë nga 6 muaj shumica prej 5-7 vjet si dhe 20 vjet burg.
2. Dënimi me gjobë shumë pak i shqiptuar gati se asnjëherë.
3. Shqiptimi i masave alternative më shumë është shqiptuar dënimi me kusht.
4. Lirimi nga dënimi shumë herë i shqiptuar (shaku i provave rast të cilën do ta elaboroj në vazhdim ku 4 persona lirohen nga vepra e ngarkuar e Grabitjes, njëri prej të akuzuarëve është edhe i mitur.

Është me rëndësi të potencohet fakti se nga bisedimi me gjyqtarin si dhe avokatin kuptova se kryerësit e veprave në gjykatë sa i përket statusit të pasurisë, ata janë të varfër

dhe gjat zhvillimit të seancës shumica e kyerësve ju drejtohen gjykatësve me fjalë: nuk e kryeva veprën nga qejfi por nga halli skam të ardhura shteti nuk ndihmon, fëmijët janë të pangopur duan të hanë, me çka nënkuptojm se rolin e veçantë ne kryerjen e veprës penale kundër pasurisë është faktori ekonomik për të cilin do flitet në vazhdim.

Rast studimi të VPG ku akuzohen 4 persona për kryerjen e veprës penale dmth vepra e kryer në grup, ku njëri është i mitur.

Të akuzuar:

1. H.I(Shqipëtar) i martuar baba i një fëmije me shkoll 8-vjeçare, punonjës në ndërtimtari me banim në fshatin G. , i pa dënuar më parë.
2. B.I(Shqipëtar) i pa martuar me shkollë 8-vjeçare, punonjës në ndërtimtari me banim në po të njejtin fshat nuk është dënuar më parë.
3. F.H (Shqipëtar) i pa martuar me shkollë 8 vjeçare i pa punësuar dhe i pa dënuar më parë.
4. B .U (Shqipëtar) i pa martuar, në kryerje të shkollës së mesme i pa dënuar më parë.

Lirohen nga akuza

Se:

Në 27.08.2006 reth orës 02:00 në fashtin G. të akuzuarit së bashku me të miturin, me përdorimin e dhunës dhe kanosjes përfshirë edhe armë, të mbuluar me maska në kokë, doreza në dorrë kanë sulmuar jetën dhe trupin e Q. V me lokacion në po të njejtin fshat me qëllim që ta marrën sendin e huaj që tju sjell përfitim.

Pikë nisja e kryerjës ka qenë nëpërmjet një dritarje e cila ka qenë e hapur ne tualet prapa shtëpijës, ku më pas kanë marrë drejtimin në dhomën ku ka qenë duke fjetur i dëmtuari(Q.V), së bashku me bashkëshorten.

I akuzuari B.I me grusht e ka goditur të dëmtuarin Q.V, dhe i është drejtuar me fjalët kanosëse "pusho mos bërtit do kalosh më mirë" , i njejt ka pasur dhe thikë me çrast përsëri i është drejtuar të dëmtuarit nxire unazën nga gishti i njejt ska pranuar ku më pas i është kanosur"nixre unazën nga gishti ose do të pres gishtin.

Përderisa i akuzuari tjetër H.I me pistoletë në dorë të drejtuar disa herë ndaj të dëmtuarit i është kanosur me fjalët "silli të hollat ose do të vdesësh dhe më pas nuk do të duhen më" , përderisa i akuzuari tjetër F.H është drejtuar me gisht duke i thënë pusho, ndërsa i mituri B.I e ka goditur me vazë lulesh në kokë.

Më pas i kauzuari H.I me pistolet në dorë i merrë me dhunë dhe i ngjit në katin e dytë ku ishin në gjumë fëmijet e Q.V, ku më pas të akuzuarit me grushtë i kanë goditur fëmijet e Q.V në kokë dhe në trup, bashkëshorten dhe Q.V. Nga e gjithë kjo dhunë që të gjithë familjarët kanë qenë me lëndime në kokë dhe në trup, ku më pas të akuzuarit marrin disa sende me vlerë si (telefona smart, produkte arri, si qafore unaza etj.) Totali i sendeve të marra kanë qenë me vlerë prej 93.480,00 denarë, pastaj dolën nga shtëpia i morrën çelësat e makinës Audi a4 makinë e cila ishte në

pronë të Q.V ndezën makinën ikën nga shtëpia dhe e kanë lënë makinën në afërsi të fshatit R. ku më pas janë larguar në drejtim të panjohur.

Me veprimet me sipërpërmendura të akuzuarit **do të** kishin kryer VPG neni 237 paragrafi 1 dhe 3 të KPM.

Shpjegim

Prokuroria themelore publike e GV i fajëson të gjithë të akuzuarit për kryerjen e VPG neni 237 paragrafi 1,3 të KPM. Në fjalën përfundimtare prokurori bëri sqarimin e dispozitës të veprës me cilën ngarkohen ku më pas thkesoi se nga hetimi dhe provat e nxjerë në vendin e ngjarjes janë të vërteta se të akuzuarit kanë kryer veprën në fjalë, me përdorimin e forcës dhunës, me përdorimin e armëve janë kanosur të dëmtuarit se do ta sulmojnë jetën apo trupin për të marrë sendin e huaj, në mënyrë më të detajuar paraqitur në aktakuzë. Mendoj se mbojtja e të akuzuarëve është e pabazë, e dhënë me qëllim që ti largohen përgjegjësisë penale.

Prokurori gërkon nga gjykata që ti besojë të gjithë deklaratës të dhënë nga I dëmtuari pasi që deklarata është në përputhje me provat e nxjera në vendin e ngjarjes. Prokurori poashtu gërkoj nga gjykata edhe dënimin me burg të akuzuarëve, ndërsa të miturit shqiptim të ndonjë mase edukative .

Avokati në fjalën përfundimtare thot se nga provat e paraqitura gjatë procedurës tregohet se të akuzuarit nuk e kanë kryer VPG që akuzohen, majde shton se në çfarë mënyre prokuroria kërkon apo përshkruan detajisht për çdo veprim të kryer të të akuzuarëve, kurse nga ana tjetër në dispozitivin, respektivisht në akuzë nuk mund të sqarohet kush nga të akuzuarit çfarë ka marrë gjegjësisht ka vjedhur nga sendet e mara psh (kush telefonin, kush qaforen etj).

Nga ana tjetër i njejt avokat shtonë se si mundet që ti njof për të dëmtuarin se çfarë veprimesh kanë ndërmar për secilin të akuzuar për derisa në dëshmi ka dëshmuar se janë me maska në kokë dhe me doreza në dorrë, njëri me pistolet e tjetri me thikë, në mënyrë që paqartësia të bëhet edhe më e madhe si mund ti vihet barra se i akuzuari H.I ka pasur pistolet të tipit HH ku e njejt nga ekspertiza e bërë nuk është gjetur, ku as edhe ndaj të akuzuarit në fjalë nuk është zhvilluar më parë procedurë për armëmbajtje neni 396, kështu është e paqartë në bazë të së cilës përfaqësuesi i prokurorisë jep një përshkrim të tillë ku edhe vetë të dëmtuarit në deklaratat e tyre nuk theksojnë se kush është fajtor dhe cili nga të akuzuarit çfarë veprim ka ndërmarrë.

Duke pasur parasysh fjalimet e më sipërme sugjeroi që gjykata të mos i besojë edhe shumë të dëmtuarit pasi që i njejt i ka ndryshuar deklaratat pasi që në seancën e parë ka potencuar se të akuzuarin H.I e ka njofur në bazë të hundës ndërsa nga ana tjetër ka qenë me maskë.

Nga të gjithë të akuzuarit në veçanti të parit ai nuk është kryerësi i veprës me cilën po akuzohet sepse edhe nga ekspertiza në bazë të marrjes së shenjave të gishtit nuk janë identike me të akuzuarit të parë. Poashtu gjatë eksepertizës së kryer ndaj veturës Audi a4 thika ka egzistuar mirëpo gjatë ekspertizës së bërë nuk janë identike me papilarët e të të akuzuarëve.

Pastaj akoma më shumë që tregon se të akuzuarit në përgjithësi e në veçanti i pari nuk ka të bëjë me kryerjen e VPG tregon fakti se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës ka qenë prezent në dasëm tek dhëndri, me çrast edhe dhëndri e potencon të njëjtën ku sejll si porvë edhe cd e dasmës, andaj gërkoj që i akuzuari i parë të lirohet me veprën që i është ngarkuar dhe mos të bazohet vetëm në një deklaratë nga i dëmtuari i cili është paqartë ku njëher thotë e kuptova nga hunda kurse pastaj kishte maskë.

Ndërsa avokati dytë në fjalën përfundimtare i njëjti shprehet se pajtohet plotësisht me fjalët e sipërthëna nga avokati i parë për të akuzuarin e parë, duke shtuar se asnjëri nga të akuzuarit për veprën në fjalë nuk janë kryerës të veprës me të cilën ngarkohen sepse e njeta vërtetohet edhe me anë të ekspertizës madje edhe me ndryshimin e deklaratave, dua të shtoj në lidhje me të akuzuarin e dytë se nga eksperstiza e bërë nga flokët e gjetur dhe pantollanat në veturë ato nuk i përputhen asnjërit nga të akuzuarit sidomos akuzuarit të dytë, madje një fakt tjetër me rëndësi është se të akuzuarit edhe pse janë të një fshati ato asnjëherë nuk kanë qenë si shokë që të shifen çdo ditë, poashtu ndaj të akuzuarit të dytë asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar qoftë për vepër penale ose kundërvajtëse, e ku të kryejnë VP në grup, andaj dua nga gjykata që ti lëroj nga akuza të akuzuarit e të gjinden kryrësit e vërtet.

Avokati i tretë në fjalën përfundimtare thotë se pikësëpari u bashkangjitem kolegëve të mi në fjalimet e sipërthëna, kërkoj nga gjykata që në bazë provave që posedon, të sjell një vendim të drejtë, pasi që i akuzuari i tretë nuk ka qenë i shoqëruar më parë me të akuzuarit tjerë, nuk ka qenë i dënuar më parë as që është udhëqur ndonjë proedur tjetër kundër tij, dhe duke pasur parasysh problemet shëndetësore, psikike i njëjti nuk është në gjendje ta kryej VP me të cilën po akuzohet.

Në fjalimin përfudnimtar avokati i fundit shprehet se u bashkangjitem plotësisht kolegëve të mi skam diçka më shumë të shtoj vetëm që i mituri i cili po akuzohet për veprën e kryer përveç faktit se babi i vet thotë se ka qenë në gjumë bile asnjëher nuk është shoqëruar me persona të moshës më të madhe se aj fjala për të akuzuarit tjerë kinse e kanë kryer VP, madje i mituri i cili ngarkohet me veprën e kryer në grup sipas prokurorisë i njëjti ka qenë si një i mituri i ri pasi që i njëjti ka qenë i lindur me 28.04.1992 (14-vjet), i njëjti tani ka më shumë se 21 vjet me çka dua të theksoj se në bazë të nenit 62 Ligjit për të drejtën e të miturëve neni në fjalë thotë: Personi që i ka mbushur 21 vjet nuk mund të gjykohet për veprim që me ligj është paraparë si vepër penale që e ka kryer si i mitur në moshë prej 14 deri në 16 vjet, me çrast dua që nga gjykata të sjell vendim lirues për pesonin në fjalë.

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet provat gjykata poashtu në bazë të të ekspertizave që janë bërë 5 her poashtu edhe ndryshimin e deklaratave nga i dëmtuari se një herë i njëf nga hunda nga ana tjetër thotë kanë maska, nga flokët, thika e gjetur në makinë në bazë të ekspertizës nuk i kanë takuar asnjërit nga të akuzuarit, poashtu edhe fëmijët në deklaratat e tyre të fundit thanë se nuk mund ti dallojmë duket se ishin zëra të ndryshëm, madje edhe shanin por me dialekt si nga kosova, sa i përket të miturit në fund nga deklarata e fundit djemve dhe bashkëshortes të dëmtuarit doli se i mituri as edhe nuk ka marrë pjesë po nga goditjet e marra në kokë në trup u janë dukur si janë 4 persona, poashtu gjykata rishqyrtoi deklaratat e parë të dëmtuarit i cili thotë se pikërisht i akuzuari i parë ishte ai i cili më drejtoi pistoletën (dmth personi i ftuar në dasëm) ku më pasë ndryshoi deklarinimin tha se sjam i sigurt gjykata vendosë që të liroj nga akuza që të katër të akuzuarit në pajtim me nenin 368 të LPP, duke ju besuar nga deklaratat e dhëna si dhe nga faktet e poseduara, me çka nuk ju besoi deklaratave të Q.V dhe bashkëshortes të cilës i ndërojn deklaratat e tyre me çrast kuptohet se ata kanë dashur ti akuzojnë ata vetëm që të nxjerin përfitime materiale për sendet e marra nga dikush tjetër.

Shpenzimet e domësdoshme të procedurës të të akuzuarit i bijnë në llogari të buxhetit të R.M ligji 93 paragrafi 1 i LPP(të vitit2005).

Gjykata të gjithë familjarët e të dëmtuarit Q.V për realizimin e kërkesës juridike pronësore i udhëzoj në diskutim, ligji 102 paragrafi 3⁵⁵.

⁵⁵ Rast i marë nga avokat në gjykatën e gostivari ku njëherit ky ka qenë si mbrojtës i të akuzuarit të parë.

III KAPITULLI I TRETË

2.1 *Nocioni dhe kuptimi i veprës penale të Vjedhjes Grabitqare*

Me Vjedhje grabitqare nënkuptojmë njëjtë si tek V.P e Grabitjes d.m.th marrjen e sendit të huaj në mënyrë të kundërligjeshme me përdorimin e forcës (dhunës dhe kanosjes), por përdorimi i forcës (dhunës dhe kanosjes) vinë në shprehje kur kryerësi zihet në befaz gjatë vjedhjes nga pronari i sendit të marrë me çrast kryerësi me qëllim që ta mbaj sendin e marrë dhunën dhe kanosjen i përdorë atëherë, d.m.th pasi është marrë sendi me çka nënkuptojmë se vejdhja veçëse është kryer si dhe vjedhja në këtë rastë i paraprinë dhunës dhe kanosjes.

Qëllimi edhe tek kjo vepër është i njëjtë kryerësi me marrjen e sendit të huaj ka për qëllim që aj send ti sjellë dobi pasurore për vete ose për ndonjë person tjetër. Kryerës mundë të jetë çdo person, sa i përket fajit edhe tek kjo V.P veprimi bëhet me dashje.

Është me rëndësi të potencojmë se nëse tek V.P.V.G plotsësohet të themi vetëm kushti i parë i vjedhjes në këtë rastë atëherë nuk do të kishim më të bëjmë me veprën në fjalë por me Vjedhje, është me doemos që edhe tek vepra në fjalë të egzistojë dhuna dhe kanosja, ku të njëjtat do të zbatohen pas kryerjes së vjedhjes pasi të jetë zënë kryerësi.

Konsiderohet se është kryer V.P.V.G në moment kur është përdorur dhuna dhe kanosja, gjatë marrjes së sendit, do të konsiderohet poashtu se është kryer V.P.V.G pa marrë parasysh se kryerësi a ka pasur sukses që sendin e vjedhur ta mbajë. Tek vepra në fjalë thelbësore është që forca të përdoret me qëllim për të mbajtur sendin e huaj (të vjedhur) nëse kjo nuk është thelbësore, bazike atëherë do të kemi bashkimin e veprave penale në mes të vjedhjes ose vjedhjes së rëndë me ndonjë vepër tjetër penale. Do të konsiderohet se është kryer V.P.V.G edhe gjatë largimit nga vendi i ngjarjes p.sh (kur kryerësi del nga banesa me sendin e vjedhur mirpo është vërejtur në korridor), dhe njëkohësisht që ta mbajë sendin zbaton dhunën ose kanosjen⁵⁶.

Sa i përket përdorimit të dhunës dhe kanojes siç cekëm më lartë ato i drejtohen pornarit poseduesit të sendit ose ndonjë personi tjetër, për përdorimin e të njëjtave është me rëndësi të theksohet se ato vinë në shprehje menjëherë pasi është kapur në befaz kryerësi me qëllim që ta mbajë sendin e marrë.

Poashtu edhe në këtë vepër penale ka rethana rënduese të cilat do ti përmendim më pas sipas K.P.M por është me rëndësi të përmendim vrasjen tek kryerja e V.P.V.G dhe tek vjedhja, tek V.P.V.G vrasja realizohet aty për aty d.m.th pasi që është zënë në befaz kryerësi nga i zoti i sendit i cili me qëllim që ta mbajë sendin kryen vperën penale të vrasjes, ndërsa tek Vjedhja vrasja nuk kryhet menjëherë mund edhe më pas, si qëllim për ta mbuluar kryerjen e vjedhjes për ta mbuluar të njëjtën d.m.th kryerësi mundohet ti largohet

⁵⁶ Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Deutsche Gesellschaft für Ineternationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH .Komentari i Kodit Penal të Kosovës 2014.fq.910

përgjegjësisë. Krahas kësaj vrasjen tek V.P.V.G e kryen vetë kryerësi ndërsa tek rasti i vjedhjes si vrasës mundet me qenë edhe ndonjë person tjetër p.sh (vrasës me pages)⁵⁷.

Në bazë të nocioneve të sipër përmendura si për Grabitjen ashtu edhe për Vjedhjen grabitqare në vazhdim do të flasim për dallimet dhe ngjashmërit e të të njejtave. Grabitja dhe V.P.V.G që të dyja janë vepra penale të përbëra, të njejtat përfshijnë vjedhjen dhe forcën (dhunën, dhe kanosjen), dallimi i tyre qëndron tek mënyra e kryerjes edhe atë:

- Tek Vjedhja grabitqare kryerësi njëher ka kryer vjedhjen, dhe me qëllim ta mbajë sendin e vjedhur përdorë dhunën apo kanosjen;
- Përderisa tek Grabitja dhuna dhe kanosja pëdoren para se me u kry vjedhja dmth që në fillim.

Sa i përket ngjashmërisë që të dyja janë identike ku të përbashkët kanë: vjedhjen, forcën (dhunën dhe kanosjen), si dhe mënyrën e sanksionimit, si dhe objektin e marrë i cili është sendi i huaj i luajtshëm.

3.2 Emërtimi ligjor i veprës penale të Vjedhjes grabitqare sipas K.P.M

Sipas K.P.M Vjedhja grabitqare emërtohet si në vijim: Ai i cili është gjetur në vjedhje do të përdorë forcë apo kërcënim së drejtpërdrejt do të sulmojë ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt me qëllim që ta mbajë sendin e vjedhur do të dënohet më së paku pesë vjet burgim.

3.3 Elementet që e përbëjnë fuguren veprës penale të Vjedhjes grabitqare

Njejtë si tek grabitja edhe V.P.V.G është vepër penale komplekse e përbërë prej elementeve të : Vjedhjes dhe Forcës (dhunës dhe kanosjes). Se çka nënkuptojmë me elementet e lartë përmendura i kemi definuar në V.P.G, por do të cekim lidhje me kanosjen edhe atë se pasi që kanosja si kërcënim i drejtohet pronarit të sendit ose ndonjë personi tjetër poashtu edhe dhuna është me rëndësi që ato të jenë e intezitetit të lartë duke mos lejuar në kundërvënje. Kërcënimi duhet të jetë seriozë respektivisht të jetë ashtu që metëvërte të krijojë frigë tek viktimja, kur kryerësi nisat drejtë të dëmtuarit p.sh me sëpatë në dorë duke i thënë fjalë “do të të pres” ndërsa në ndërkohë sëpatën e mban poshtë dhe nuk i afrohet pronarit të sendit por qëndron larg, nënkuptojmë se kryerësi nuk ka pasur ndonjë qëllim seriozë për lëndimin e trupit apo rezikimin e jetës së viktimës në këtë rast kemi të bëjmë me kanosjen e jo inteziteti të lartë por vetëm frikë me anë të fjalëve me çka kërcënimi i kryerësit orientuar të dëmtuarit nuk është në këtë rast e intezitetit të lartë e cila është e nevojshme për plotësimin e veprës penale të V.P.V.G⁵⁸.

⁵⁷ Nikola Srzentiñ, Komentari i Koodit Penal të Sërbisë, Beograd 1995, fq 118 pa vit botimi

⁵⁸ Petar Novoselac, E Dretja Penale, Pjesa e Posaçme, Zagreb 2007, fq 231

3.4 Trajtimi i veprës penale të Vjedhjes grabitqare sipas kodeve penale të (R.Maqedonisë, R.Shqipërisë, R.Kosovës).

3.4.1 Trajtimi i veprës penale të Vjedhjes grabitqare sipas K.P.M-së

Trajtimin e V.P.V.G sipas ligjit në fjalë, mënyra se si përkufizohet dhe si trajtohet nga ana Kodit Penal të R.M-së, e hasim në nenin 238 të të njejtit Kod si në vijim:

1. Ai i cili është gjetur në vjedhje, do të përdorë forcë apo kërcënim të drejtëpërdrejtë, do të sulmojë ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt me qëllim që ta mbaj sendin e vjedhur, do të dënohet më së paku 5 vjet burgim.
2. Nëse vlera e sendit të vjedhur është me përmasa të mëdha kryerësi do të dënohet më së paku tetë 8 vjet burgim.
3. Nëse vlera e sendit të marë është më e vogël, kryerësi do të dënohet prej 1 deri në 5 vjet.
4. Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 ndonjë personit me paramendim i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor apo nëse vjedhja grabitqare është kryer në përbërje të grupit, bandës ose nëse është përdorur armë zjarri apo mjet i rrezikshëm, kryerësi do të dënohet më së paku 10 vjet burg.
5. Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 ndonjë personit me paramendim i është marrë jeta, kryerësi do të dënohet më së paku 10 vjet ose me burg të përjetshëm⁵⁹.

Nga kjo që lartëpërmendëm konstatojmë një emërtim të ngjashëm me atë të veprës penale të Grabitje si në emërtim poashtu edhe në sanksionim ku i vetmi dallim konsistonë nga ajo që lartëpërmendëm pra se tek Grabitja forca përdoret që në fillim, ndërsa tek Vjedhja grabitqare zbatimi i forcës përdoret pasi është vjedhur sendi, andaj në vazhdim nuk do ti komentojmë paragrafet pasi që kanë tepër ngjashmëri. Por është me rëndësi që të theksojmë vetëm faktin se në paragrafin e parë kryerja e V.P.V.G është forma e rëndomtë, ndërsa si formë e rëndë më cilësuese është kur kryerja e veprës në fjalë kryhet d.m.th nga banda apo grupi ose kur i merret jeta ndonjë personi nga paragrafi 3,4.

Tek V.P.V.G nga vetë emërtimi ligjor (“me qëllim që sendin e vjedhur ta mbajë”) konstatohet atë që u lartëpërmend se vjedhja është kryer, nëse kryerësi përdorë forcën në kohën e marrjes së sendit, respektivisht nëse vjedhja akoma nuk është kryer atëherë kemi të bëjmë me Grabitje. Nga vetë natyra e saj V.P.V.G është vepër e drejtuar kundër pronës,

⁵⁹ Shih librin e Afrim Osmanit, KPM, Shkup 2015, fq.199

edhe kundër lirisë së vendosjes, ajo që i jep sërish karakter të veprës penale kundër pasurisë është dominimi i qëllimit fitimprurës me antë të forcës, dhunës, dhe kanosjes ⁶⁰.

3.4.2 Tratimi i V.P.V.G sipas Kodit të R.Shqipërisë

Sa i përket kodit në fjalë tek vepra e Grabitjes theksuam më detajisht në lidhje me vperat penale kundër pasurisë në përgjithësi si dhe për veprën e vjedhjes në atë se si i ndanë veprat penale kundër pasurisë K.P.SH duke mos u përsëritur prapë do të theksojmë vetëm faktin se në Kodin në fjalë as V.P.G por as V.P.V.G nuk kanë qenë fare të inkrimuara përderisa vepra penale e grabitjes në kodin e mëparshëm kishte qenë por të ngjashme me V.P.G lartëpërmendëm që karakteristike është se në K.P.SH e përafërt është vjedhja me dhunë, e cila njëkohësisht potencuam se tek kodi në fjalë dhuna vinte në shprehje edhe gjatë marrjes së sendit mirëpo edhe pasi është marrë sendi që nënkuptojmë një vepër mikse e veprave penale të V.P.G dhe V.P.V.G të cilat në K.P.M janë me theksë të veçantë.

Në vazhdim të kodit në fjalë do të paraqesë një aktgjykim të shqiptar për veprën e vjedhjes me dhunë si dhe rethanën rënduese të vjedhjes me pasojë vdekjen e cila parashifet tek K.P.M për të dyja V.P.G dhe V.P.V.G në paragrafet e 5-ta, andaj në vazhdim do ta elaborojmë rastin e Vjedhjes me dhunë e kryerë në bashkëpunim e cila ka rezultuar me vdekje një rast mjaft interesant i marrë nga një gjyqëtar në gjykatën e Durrësit.

TË PANDEHUR:

- 1. A.H,** i dënuar më parë , hetuar dhe gjykuar në munges.
- 2. F.M,** i pa dënuar më parë, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi Arrest në burg.

Akuzuar:

Për veprat penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, vjedhjes me dhunë e kryer në bashkëpunim, dhe mbajtjes pa leje të armëve.

Një vepër penale mjaftë e rëndë gjykimi i së cilës ka filluar dmth që nga viti i kryerjes në vitin 2004 dhe ka mbaruar më 2011 rasti ka kaluar nëpër gjykatat e shkallës së parë e deri tek më e larta andaj në vazhdim do të paraqesim rastin si ka ndodhur e gjithë kryerja e veprës si dhe vendimin e marrë nga Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Me datë 12.07.2004 rreth orës 01.45 të gjykuarit, pasi janë marrë vesh më parë me njëri-tjetrin, kanë shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit M.S dhe pasi kanë vënë në kokë kapuçat

⁶⁰ Vlado Kambovski, Komentari i KPM, Shkup 2011, fq 923

kanë kapërcyer murin rrethues dhe janë futur në oborrin e banesës private të të dëmtuarit, e cila ndodhet në Rrugën "B", në qytetin e T.

I akuzuari i parë mbante në dorrë një thes ku kishte futur automatikun e tij, një copë litar, një thikë dhe një ngjitëse, të cilat ia kishte dhënë më parë i akuzuari i dytë, ndërsa ky i fundit ishte i armatosur me një pistoletë.

Pasi kanë lënë thesin në oborr të akuzuarit të armatosur i janë drejtuar njëri pas tjetrit hyrjes së banesës dhe i akuzuari i parë, pasi ka hapur derën ka hyrë në dhomën e gjumit të të dëmtuarve, përderisa i akuzuari tjetër me automatik në dorë ka qëndruar në korridor ku po flinte viktima.

Në momentin kur i akuzuari A.H ka hyrë në dhomën ku flinin të dëmtuarit M.S dhe H.S, i gjykuari F.M ka dëgjuar të bërtiturat e një gruaje prej të cilave është zgjuar viktima G.S, i cili ka kapur automatikun që mbante në dorë i akuzuari F.M

Në kohën që i akuzuari A.H ka dalë nga dhoma e gjumit të çiftit , duke u përleshur me ta, i akuzuari tjetër F.I ka mbushur automatikun dhe ka qëlluar, sepse viktima G.S nuk po ia lëshonte armën.

Më pas i akuzuari F.I ka dëgjuar të shtëna pistolete pranë vendit ku ishte parkuar makina e pronarëve dhe më pas ka parë viktimën që është rrëzuar përtokë.

Pasi kanë kapërcyer murin rrethues të banesës të akuzuarit kanë dalë në rrugë dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të bregut të lumit ku kanë hedhur armët dhe kanë djegur rrobat në mënyrë që të fshihnin gjurmët e krimit.

Gjatë rrugës i akuzuari A.H i ka treguar bashkëpunëtorit tjetër se personat me të cilët ishte përleshur i kishin hequr maskën, prandaj ai kishte qëlluar dhe në oborrin e shtëpisë i kishte mbetur njëra atlete, përderisa F.I i pohon se thesin që kishte me materiale e kishte lënë në oborrin e banesës.

Të nesërmen F.I ka shkuar në qytetin e E. tek shtëpia e xhaxhait të tij ku edhe është arrestuar, përderisa A.H që nga ajo ditë i fshihet drejtësisë.

Pas kryerjes së veprimeve të para hetimore ka rezultuar se nga kjo ngjarje e rëndë ka mbetur i vdekur viktima G.S, është plagosur rëndë i dëmtuari M.S dhe është e plagosur lehtë e dëmtuara H.S, prandaj organi i akuzës i ka dërguar në gjyqë të gjykuarit, duke i akuzuar ata për veprat penale të vjedhjes me pasojë vdekjen të kryer në bashkëpunim, vjedhjes me dhunë të kryer në bashkëpunim dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 141-25, 139-25 dhe 278/4 të Kodit Penal.

Gjykatat e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Tiranë vendosën:

Deklarimin fajtor të të pandehurit A.H për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit G.S, e kryer në bashkëpunim dhe në bazë në nenit 141-25 të K.Penal dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri A.H në dëm të shtetasit M.S nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të K.Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri A.H në dëm të shtetasës H.S nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të K.Penal, në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit A.H për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të K.Penal, dënimin me 10 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit në fjalë me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të pandehurit F.M për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit G.S, e kryer në bashkëpunim dhe në bazë në nenit 141-25 të K.Penal dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri në fjalë në dëm të shtetasit M.S nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të K.Penal, në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim. Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri në fjalë në dëm të shtetasës H.S nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të K.Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të pandehurit të dytë për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të K.Penal, dënimin me 10 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit të dytë me burgim të përjetshëm.

Vuajtja e dënimit të të pandehurit në fjalë fillon nga dita e arrestimit në flagrancë.

Tiranë, më 30.09.2011

3.4.3 Trajtimi i VPVG sipas Kodit Penal të R.Kosovës

Pasi që sipërpërmendëm më lartë për V.P.G se Kodi ynë dhe Kodi në fjalë për sa i përket emërimit si të V.P.G poashtu edhe tek kjo veprë janë gati se të njejta në emërtimime, me dallim vetëm tek mënyra e sanksionimit, pasi që Kosova ka qenë krahinë autonome e shteteve të Federatës Jugosllave ndërsa, Maqedonia Republikë e Federatës Jugosllave, andaj që të dyja shtetet në atë kohë kanë pasur një sistem juridik i cili edhe sot e kësaj dite si në Kroaci, Sërbi, Maqedoni, Bosnje, Mal i Zi, dhe Kosova tek veprat penale kundër pasurisë janë shumë të ngjashme në emërtimet e veprave në fjalë.

Sipas legjislacionit të R.Kosovës mënyra se si përkufizohet dhe sanksionohet V.P.V.G do të elaborojmë përmes nenit 328 të Kodit në fjalë edhe atë:

- 1) Kushdo që i zënë në befas në kryerjen e aktit të vjedhjes dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, përdor forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 3 deri në 10 vjet.
- 2) Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 5 deri në 12 vjet.
- 3) Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtarë i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 7 deri në 12 vjet.
- 4) Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku 10 vjet ose burgim të përjetshëm⁶¹.

Nga nenet e lartëpërmendura për veprën në fjalë mund të konstatojmë se V.P.V.G fillon me kryerjen e vjedhjes, për mbajtjen e sendit të vjedhur ku kryerësi duhet të përdorë forcën, dhunën, përodrimi i forcës duhet që të vi në zbatim në moment kur zihet së bashku me dhunën dhe kanosjen serioze.

Veprimi i kryerjes së veprës në fjalë është përdorimi i elementeve që e karakterizojnë po të njejtën pra elementi i dytë forca (dhuna dhe kanosja), e shfaqur drejtpërdrejtë kundër integritetit fizik ose jetës së personit tjetër me qëllim për të mbajtur sendin e vjedhur, elementi në fjalë mundë të jetë i drejtuar ose ndaj pronarit të sendit por edhe ndaj ndonjë personi tjetër. Për sa i përket objektit mbrojtës të V.P.V.G sipas K.P.K është pasuria e cila merret nga vjedhësi me qëllim përfitimi.

Ndërsa kryerësi është ai që ka kryer veprën në fjalë me anë të dashjes, viktima është pronari ndaj të cilit merret sendi ose ndonjë person tjetër i tretë.

⁶¹ Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Komentari i KPK botimi 2014 fq.910.

Sa i përket krahasimit të V.P.V.G në mes K.P.M dhe K.P.K shohim se në V.P.V.G të K.P.K krahas asaj që tek V.P.G sipas Kodit të Kosovës në paragrafin dytë potencohet si “nëse vlera e sendit të marrë tejkalon shumën e 5000 eurove” tek V.P.V.G nuk egziston e lartësia e shumës së marrë, poashtu edhe atë që përmendëm më lartë, pra mënyra e sanksionimit është më i ashpër, si dhe nocioni neneve është pak më ndryshe përkufizuar në krahasim me K.P.M mirëpo nëse shikohet esenca ato janë të njejta kanë një domethënje.

Forma themelore e kryerjes së V.P.V.G është në paragrafin e parë përderisa si formë më rëndë paraqitet rasti kur V.P.V.G kryhet me anë të grupit me çrast është shkaktuar ndonjë lëndim i rëndë ose ka ardhur deri tek vdekja.

Sipas K.P.K egziston V.P.V.G kur i akuzuari, të dëmtuarit nga dora ia ka marrë të hollat dhe i ka vënë në xhep dhe ka dëshiruar të largohet, por kur i dëmtuari ka intervenuar dhe e ka kapur për beli, vjedhësi e ka goditur në nofull me grusht e ka rrëzuar në tok dhe ka ik. Për ta kryer veprën penale të V.P.V.G kryerësi duhet që për ta mbajtur sendin e huaj të përdorë forcën apo kanosjen. Meqenëse i akuzuari pasi e ka hap veturën e të dëmtuarit është zënë nga i njejt por nga vetura e të njejt nuk ka marrë asnjë send ku kishte mundur të marrë, atëherë i akuzuari me revole ka krisur në ajër. Pasi që i akuzuari vetëm ka tentuar ta kryej V.P të vjedhjes dhe ka poseduar armën për sulm apo mbrojtje, ashtu që qëllimi i përdorimit të armës del se ka qenë frikësimi dhe largimi i të dëmtuarit, që nënkuptohet se i akuzuari nuk ka kryer V.P.V.G por dy vepra penale në bashkim V.P të vjedhjes së rëndë në tentativë dhe V.P të Kanosjes.⁶²

3.5 Shqiptimi i sanksioneve për veprën penale të Vjedhjes grabitqare

Sa i përket kuptimit të sanksioneve llojet e të njejtave sipas K.P.M i kemi shfaqur më gjerësisht tek vepra penale e Grabitjes duke mos u përsëritur në vazhdim do të falsim për Vjedhjen grabitqare sipas statistikave të entit statistikor të R.M-së, si dhe statistika të marra nga ana e gjykatës së Gostivarit së bashku me një rast studimi.

Duke u bazuar në nenin 238 të K.P.M mund të konstatojmë se si sanksione të parapara për V.P.V.G ishin dënimet me burg edhe atë dënime prej 1 vjet deri në burg të përjetshëm.

Pasi që tema në fjalë ka të bëjë me vështrimin komperativë të 3 shteteve (R.M, R.SH, R.K), sanksionet më të ashpra në bazë të neneve të lartëpërmendura shohim se shteti ynë për sa i përket dënimeve me burg janë më të buta, në krahasim me shtet e R.SH, R.K, përveç në veprën kur ka ardhur deri tek marrja e jetës së ndonjë personi.

⁶² Po aty për më gjerësisht shih edhe praktiken gjyqësore nga i njejt libër fq 912

Karakteristikat themlore të sanksioneve janë:

- Sanksionet shqiptohen nga ana e gjykatës;
- Të njejtat u shqiptohen kryerësve të veprave penale;
- Me anë të sanksioneve kryerësve u kufizohet disa të drejta dhe;
- Me sanksione penale shqoëria mbrohet nga krimet⁶³.

Në vazhdim do të paraqesë njëherë tabelën e marrë nga enti statistikor i R.M.

Tabela 1.

Vepra penale kundër pasurisë	Totali	Kryerësit e njohur	Femra	Kryerësit e panjohur
Vjedhja	4180	839	67	3341
Vjedhja e rëndë	6301	1035	27	5266
Grabitja	277	78	4	199
Vjedhja Grabitqare	17	10	0	7

Të dhëna nga enti statistikor i R.M⁶⁴

Në këtë tabelë kemi pasqyruar disa të dhëna të disave veprave penale kundër pasurisë ku ndër to shofim se vepra të cilën jemi duke folur pra V.P.V.G pasi që të tjerat i kemi elaboruar tek V.P.G, konstatojmë se krahas V.P.G, Vjedhjes, dhe Vjedhjes së rëndë, vepra penale e Vjedhjes grabitqare është shumë pak e paraqitur përderisa edhe femra si kryerëse e veprës në fjalë nuk ka qenë kryerëse.

Vlen të theksohet fakti që tek V.P kundër pasurisë si vjedhja, dhe vjedhja e rëndë janë vepra të cilat kryhen në një numër më të madh.

Më poshtë do të paraqesë tabelën në lidhje vetëm me V.P.G dhe V.P.V.G.

⁶³ Nga ligjeratat e studime deri diplomike në të Drejtën penale ligjruar nga Ismail Zejnli

⁶⁴ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>

Tabela 2.

Të gjykar për veprat penale të:	Dënimet:	Burgim i përjetshëm	Burg deri 20 vjet	10-15	5-10	3-5	2-3	1-2	6 muaj deri 1 vjet	Deri 6 muaj
Grabitjes dhe	44	0	1	6	15	11	5	1	4	1
Vjedhjes grabitqare	10	0	0	1	3	2	1	2	1	0

Të dhëna nga enti statistikor i R.M⁶⁵

Pasi që ky punim ndërlidhet vetëm me Grabitjen dhe Vjedhjen grabitqare si vepra penale kundër pasurisë mundë të konstatohet qartë se vepra penale e Vjedhjes grabitqare në krahasim me Vjedhjen, Vjedhjen e rëndë, dhe Grabitjen edhe për sa i përket rasteve të paraqitura, akuzuara si dhe të dënuara, janë më të pakta se sa veprat tjera që i përmendëm.

Nëse shofim se sa janë të gjykuar del një numër mjaft i vogël vetëm me 10 persona krahasim me Grabitjen, ndërsa dënimi më shumë i shqiptuar për V.P.V.G është ai i 5 deri në 10 vjet.

Është me rëndësi të flietet për këtë numër të vogël thua vallë është e vërtet që të ketë kaq pak vepra të V.P.V.G?.

Duke u bazuar në statistikat e entit statistikor si dhe të dhënave të marra nga gjykata e Gostivarit mundë të konstatojmë se ky numër duhet të jetë i vërtetë nga fakti se vepra në fjalë apo respektivisht elementi i cili e karakterizon dmth përdorimi i dhunës apo kanosjes kur zihet kryerësi duke vjedhur në praktikë ndodhën rallë prandaj numri i vjedhje është në numër shumë të madh sepse kryerësit nuk janë zënë nga pronari i sendit me çrast vepra përfundon në veprën penale vjedhje.

Nga ky konkluzion dua të potencoj faktin se në shtëpinë e disa banorëve të një fshati nga rethina e Gostivarit reth viteve 2003-2007 janë hasur me veprën penale të vjedhjes plot 5 herë dhe gjithmonë duke mos qenë asnjë anëtarë i shtëpisë brenda, të njëjtët kanë tentuar kinse largohen nga shtëpia duke u fshehur në katin më të lartë të shtëpisë (të themi një rrezik majft i madh kjo pritje por në shtetin tonë ndodhën pasi që aftësia e organeve kompetente të themi në kuptimin e plot të fjalës është mjaft i dobët mbase edhe mos zërja e kryerësve mundet të kenë qënë si pasoj e asaj se edhe ato mundet të kenë qenë vetë pjesëmarrës), i gjithë ky rrezik d.m.th pritja e kryerësve për të zbuluar se kush e kryen veprën e vjedhjes nuk ndodhi asnjëherë që nënkuptojmë se nga këndvështrimi i parë janë ndjekur nga ndonjëri kur janë larguar nga shtëpia dhe vepra është kryer, akoma më karakteristike është se asnjëherë edhe përveç faktit se kanë egzistuar prova shumë të dukshme p.sh

⁶⁵ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>

shenja nëpër shtëpi saktësisht në disa dhoma si dhe disa këpucë jashtë oborrit të shtëpisë asnjëherë nga organet kompetente nuk u gjindën kryerësit që të zbardhet rasti.

Mund të themi që V.P.V.G është në numër akoma më të vogël në vendet rurale, gjithashtu në shumicën e rasteve vjedhjet ndodhin ku asnjë nga antarët nuk është në shtëpi përveç veprës penale të Grabitjes në të cilën kryerësit janë të gatshëm në kuptimin e shprehjes së dhunës që momentin e hyrjes në shtëpi.

Pas paraqitjes së tabelës me të dhënat e marra për V.P.V.G nga enti statistikor i R.M tani do të paraqes statisitka të veprës në fjalë të marra nga gjykata e Gostivarit.

Tabela 3.

Vitit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Gjithësjet
VPVG	0	0	1	1	0	1	1	4

Krahas të dhënave nga enti statistikor i R.M me çrast V.P.V.G ishte në numër mjaftë të vogël siç shohim edhe në rethinën e Gostivarit për veprën në fjalë gjatë 6 viteve kemi vetëm 4 raste sa i përket llojit të shqiptimit të sanksioneve të njejtat nuk arrita që ti marrë se çfarë lloji dënimi është shqiptuar në fjalë por me ndihmën e një gjyqëtari i cili në të 4 rastet ka gjykuar i njejtë më ndihmoi si dhe më shpjegoi se çfarë lloji vendimesh shqiptohen.

Nga tabela e paraqitur shohim se në vitin 2010, 11, 14 nuk ka patur asnjë rast të V.P.V.G përderisa tek vitet 2012, 13, 15, 16 vetëm nga një rast.

Nga të dhënat e marra nga gjykata në fjalë personalisht mu duk një numër shumë i vogël pak sa i pa kapshëm me çrast bëra një kërkesë në gjykatën e Tetovës ku më intersonte se çfarë numri ka atje dhe rezultati ishte i njejtë d.m.th vetëm me 4 vepra penale të V.P.V.G bile jo të periudhës 2010-2016 por me periudhë për 2 vite më tepër.

Për as i përket llojit të shqiptimit të sanksioneve të 4 veprave penale të V.P.V.G në Gostivar kanë qenë:

- Dënimi me burg për veprën e V.P.V.G të vitit 2012 me 6 muaj ;
- Dënim me burg për veprën e V.P.V.G të vitit 2013 me 1 vit;
- Dënim me burg për veprën e V.P.V.G të vitit 2015 me 3 vjet;
- Dënim me burg për veprën e V.P.V.G të vitit 2016 me 9 vjet.

Rast studimi i V.P.V.G :

I akuzuari : Me initiale **E.I.** i pa martuar të mbauar shkollën fillore i pa dënuar më parë i lindur dhe njëkohësisht jeton në fsh.Gj.

Akuzohet pëshkak se në ditë të vitit reth orës ... në fshatin Gj. është kapur në vjedhje i njejtë ka përdorur forcë, dhe kanosje se do ta dëmtoje jetën apo trupin e pronarit

me qëllim ta mbajë sendin e vjedhur. Kryerja e veprës në fjalë si zakonisht është kryer në orët e vona ku vjedhësi ka përdorur dritaren e banjos nëpërmjet së cilës është futur dhe më pas është ngjitur në katin e parë përderisa i zoti dhe gruaja kanë qenë në gjumë dhe ka filluar me kërkimin. Gjatë kërkimit ka gjetur të holla si dhe disa sende tjera me vlerë, pa i mjaftuar sendet që i ka marrë vjedhësi kërkon akoma sende tjera i zoti i shtëpisë del në tualet dhe parpritmas në katin poshtë dëgjon diçka dhe zbret, në momentin kur zbret e shikon një person të maskuar me thikë dhe me disa armë tjera të ftohta si psh (bejzboll), i zoti i shtëpisë kur haset në këtë situat i thotë vjedhësit që të lë sendet e marrura dhe të ik dhe se zdo lajmëroj policinë.

Vjedhësi nuk e pranon ofertën por i drejtohet largohu se do të pësosh keq, me çrast i zoti nuk largohet por afrohet pranë tij, duke u afruar vjedhësi me bejzbollin në dorë i drejtohet pronarit në kokë duke i shkaktuar lëndime dhe me sendet e marra vrapon dhe ikën me çrast ai kryen VPVG të nenin 238 të KPM paragrafi 1 të KPM, për këtë veprë gjyqi e vjedhësin e dënon me burg prej 3 vjetësh.

Pasi që ky gjykim ka zgjatur edhe më shumë si në fjalimin e prokurorit të akuzuesit avokatit un vendosa që në pika të shkurta të tregoj ndodhin me kryesore.

Do të potencojmë vetëm se gjatë zhvillimit të senacës gjyqësore i akuzuari ka qenë në moshë të re dhe se e ka pranuar fajin i njejtë kërkon falje duke pretenduar se ka qenë i ri dhe se ndaj të njetit asnjëherë nuk është zhvilluar më pare ndonjë procedurë tjetër. Më lartë tek VPVG tek mënyra se si e përkufizon KPM pamë se sanksioni penal për këtë veprë ishte 5 vjet, mirëpo në këtë rast gjyqtari duke parë disa rethana lehtësuse si rethanat që përmendëm mosha dhe pranimi i veprës njëkohësisht kërkimi i faljes i shqitpon 3 vjet burg.

IV KAPITULLI I KATËRT

4.FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KRYERJEN E VPERAVE PENALE TË GRABITJES DHE VJEDHJES GRABITQARE

4.1 FAKTORËT OBJEKTIV

Pas gjithë këtij elaborimi të këtyre dy veprave penale si në aspektin historik, poashtu edhe atë juridik normalisht për kryerjen e veprave në fjalë duhet të egzistojë edhe ndonjë faktorë se pse vjen deri tek kryerja e këtyre veprave, andaj në vazhdim do të përshkruajmë disa faktorë të cilët luajn rolë mjaftë të rëndësishëm në kryerjen e të njejtave.

Për sa i përket literaturës kriminalstike faktorët objektiv paraqesin rol të rëndësishëm për kuptimin dhe shpjegimin e atyre rethanave të cilat çojnë deri në kryerjen e veprimeve të jashtëligjshme. Sipas kriminologëve faktorët në fjalë ndikojnë drejtëpërdrejtë në kryerjen e veprave të jashtëligjshme.

Sa i përket faktorëve të jashtëm ata janë shumë mirëpo në vazhdim do të përmendim disa faktorë të jashtëm prej së cilave dhe vjen deri në kryerjen e V.P.G dhe V.P.V.G edhe atë:

- Ndikimi i krizave ekonomike;
- Papunësia;
- Jetesa në kushtet e vështira dhe;
- Alkoolizmi dhe Narkomania.

Më poshtë do të flitet për secilin nga faktorët objektiv të lartpërmendur do të flasim se si këta faktorë ndikojnë tek individët të jenë kryerës të veprave penale kundër pasurisë respektivshite veprës penale të Grabitjes, dhe Vjedhjes grabitqare.

4.1.1 Ndikimi i krizave ekonomike

Ndikimi i krizave në fjalë është njëri ndër faktorët më kryesorë që vjen deri tek kryerja e veprave penale, jemi vetë dëshmitarë të kohës që jetojmë në një jetë kaq dinamike veçanërisht në shtetin tonë për sa i përket çështjes ekonomike lirisht mund të konstatojmë se në R.M kemi dy shtresa, ku njëra shtresë është e pasur të mos themi mjaftë, dhe shtresa tjetër është tepër e varfër.

Që nënkuptojmë se shtresa e mesme mungon siç kemi përshmebull shtetet perendimore. Nëse jemi realist në këtë jetë të themi lakmitare ku i pasuri i ka të gjitha kushtet për jetesë, ndërsa tjetri nuk posedon kushtet elementare si psh: me se të ngrohet, të pangopur, e shumë rethana tjera, normalisht që kryerja e veprave penale V.P.G dhe V.P.V.G do të jete prezente shumë e më shumë.

Sa i përket çështjes ekonomike do të fokusohemi në shtetin tonë shtrohet pyetja se rroga e shtetit pa marrë parasysh sa është a thua vallë mundet që tia dalë apo ta arrijë fundin e muajt një individë tek i punësuar, nga i cili presin respektivisht mvaren familjarët e të njejtit, ose në anën tjetër taksat shtetërore, korenti, gjobat, a janë ekuivalent me rrogën?.

Apo në rastë se analizojmë gjobat në komunikacion sa janë në shtetin tonë lirisht mund themi se jemi shtet i veçantë se në çfarë shifrash është një gjobë apo thënë bukfalisht një gjobë e barabartë me një rrogë apo edhe më shumë.

Krizat ekonomike si faktorë mjaftë i rëndësishëm për kryerjen e çfarëdo veprave penale vlenë të theksojmë se mvaret edhe nga ekonomia e shtetit se në çfar gjendje është, p.sh jo rastësisht shtetet Skandinave janë vendi me më pak sjellje devijante, gjithashtu edhe në shtetet më të përparuara se vendi ynë ka krime por faktori për të cilin po flasim mund të konstatojmë se është shumë pak i pranishëm. Në rastë se analizojmë teorinë e sociologut Qezaro Lombrozës i cili thot se kriminelat janë të lindur jam i mendimit se kta krimenela në shumicën e rasteve i hasim në perëndim.

Sa i përket faktorit ekonomik në vazhdim do të paraqesë edhe një rastë studimi me me një fshatarë të rethinës së Gostivarit ku gjatë bisedës së zhvilluar i njejt thekson se si ekonomia e dobët ka ndikuar jo vetëm në kryerjen e veprës penale por edhe në shkatërrimin e familjes.

Personi me iniciale të mbrojtura i punësuar në punë të shtetit me x profesion baba i 3 fëmijëve shpreh pakënaqësi në rrogën e marrë si dhe në marrjen e pagës me vonesë. I njejt tregon se nga rroga e përfitur dhe si anëtarë i vetëm i punësuar nuk ka mundur ti plotësoj kushtet elementare të familjes se vetë ku edhe si pasoj e vonesës së pagës ka ardhur në pozitë të vështirë si p.sh i është ndërprerë me javë korenti.

Në vazhdim nga gjithë këto probleme është mjaftë e logjikshme që do kërkojmë zgjidhje ndonjëri nga opinioni mund të thotë ik jashtë shtetit (si rrugëdalje), të themi se ikja nga shteti do të ishte e drejtë por ajo ikje do ca kushte të veta p.sh personi në fjalë nuk posedon letra dhe ne e dimë se pa letra europiane është e vështirë të lëvizësh në kuptimin e fjalës që të punojë, nga e gjithë kjo gjë personit në fjalë akoma më shumë ja vështirëson gjendjen edhe asistencë e shtetit i cili nuk mund të marrë asgjë edhe pse ka tentuar duke uaqarë hallin organeve kompetente.

Nga ky rast shpëtimi i vetëm i këtij personi dashur e pa dashur është vetëm në dy mënyra e para kryerja e ndonjë veprë penale, ose të ketë ndonjë familjar me ekonomi të mirë dhe që ti ndihmojë. Dhe në fund ndodhë që personi kryen një vepër penale me çrast më pas pëson dhe sanksion me burg, sanksion i cili në vazhdim sjell probleme akoma më shumë i hudhet barrë mjaftë e madhe bashkëshortes se si ajo tani do kujdeset për fëmijët a thua vallë do të ketë ndonjë ndihmesë nga shteti ku shembullin e pati nga vetë bashkëshorti i saj.

Dhe si përfundim i ati në burg fëmijët fillojnë me veprime tjera devijante duke mos patur rrugëdalje tjetër dhe në fund vjen deri tek prishja e një familje. Në rastë se analizojmë këtë rast shofim dukshëm se faktorë kryesorë i prishjes së kësaj familjeje, erdhi si pasojë e shtetit. Në vend që shteti të ndërmerë ndonjë veprim ndonjë ndihmesë për lehtësim ndodh e kundërta.

Kemi raste ku shumë anëtarë jetojnë në kushte të vështira jetese, pa shtëpi dhe nëpërmjet rrjeteve sociale shofim dukshëm se si këta njerrëz bëhen me banesa të reja nga persona jo shtetërorë p.sh zotri Elvis Naçi teologun e Tiranës një person me profesionë teolog mundohet strehon shumë familje e shteti me gjithë atë fuqi qëndron në një anë. E potencoj telogoun jo për diçka por një shtëpi e dhuruar të hekë një barrë mjaftë të madhe pasi që vjen muaji nuk të mundon fakti se si ti mbledhësh parat e qirasë, e pastaj detyrimet tjera e pastaj të ngelë diçka për të ngrënë, që nënkuptojmë se edhe ardhja deri tek kryerja e veprave penale do të jetë shumë rallë.

4.1.2 Papunësia

Edhe papunësia njejtë si ekonomia luan rol mjaftë të rëndësishëm në kryerjen e veprimeve kriminale. Papunësia një fenomen mjaftë i përhapur sidomos në shtetin tonë i cili rendidet ndër vendet e para me papunësi të madhe.

Sa i përket papunësisë është për të ardhur keq se të papunësuar qëndrojnë persona që duhet të ishin të punësuar ndërsa në realitet ndodh e kundërta nga lojrat e shtetit dhe politikës që luhen në R.M.

Papunësia është e ngjashme me dukurin e varfërisë që nënkuptojmë vështirësi në punësim gjë që sjell deri në probleme të mëdha si p.sh egzistenca, në rastë se kemi të bëjmë me papunësi për një kohë të gjatë atëherë vjen deri në skamje dhe varfëri të madhe, dukuri të cilat akoma më shumë i shtojnë problemet jo vetëm në aspektin social po edhe atë psikik, ku më pas rezulton në sharrje, qortime në mes bashkëshortëve, fëmijëve, gjë që pëson shkatërrimin e familjes nga dukuri të ndryshme si alkooli, narkomania, prostitucioni etj⁶⁶.

Sa i përket papunësisë do të potencojmë më shumë gjinin femërore ku si rezultat i këtijë fenomeni ata pësojnë më keq nga aspekti moral psh nëse një femër qëndron gjatë me statusin e pa punë, duke tentuar të dalë nga kjo gjendje mundohet të ikë jashtë vendit duke iu garantuar ndonjë punë, ku shpesh përfundojnë në punë të rreme ku përfundojnë në fund trafikante.

Papunësia është prezente në të gjitha vendet e botës por në Ballkan respektivisht flasim për vendin tonë është për të ardhur keq sepse numri i personave të aftë për punë është në rritje, dhe për të dalë nga ky fenomen shpesh kryejnë veprën e vjedhjes me çka nënkuptojmë se rritja e papunësisë gjithashtu luan rol të rëndësishëm në kryerjen e këtyre veprimeve kriminale.

Faktori në fjalë si dukuri dhe problem social vjen në shprehje edhe gjatë krizave dhe recesioneve ekonomike, përshkak të pamundësisë për plotësimin e nevojave elementare nga ana e prindërve fëmijeve të vet sjell deri në braktisjen e edukimit d.m.th vazhdimin të shkollës me çka vjen deri në paraqitjen e sjelljeve kriminale.⁶⁷

Dhe si përfundim që të dy faktorët janë mjaftë të ndërlidhur në mes veti si ai ekonomik dhe faktori për të cilëm po flasim sepse një njeri i punësuar të paktën ekonominë e vet e mbanë në një balancë mundet të mbulojë disa shpenzime. Se sa shteti ynë mundohet në këtë aspekt për zvogëlimin e të papunësuarve është për të ardhur keq, ku biles edhe investitorëve të jashtëm u vështirsohet investimi, saktësisht do të tregoj rastin me një investitor nga shteti i Sllovenisë para 3 viteve i njejtë kishte lidhje të fuqishme me IPA

⁶⁶ Xhorxhe Ignjatoviç, Kriminologjia, Beograd 2008, fq 170

⁶⁷ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq 249

FOND-et eurapiane i cili erdh në një fshat të rethinës së GV, nga ftesa e një personi i njejtë me biznes në po atë shtet. Investitori deshte të investojë tek ujësjellësi konkretisht renovimin e rrjetit të ujësjellësit por që e njehta nuk ju relizuar sepse organet kompetente për lejimin e investimeve donin që ky tua ap paratë e relizimin e projektiti do ta bënin këta ku edhe ky do të kishte përqindje. Në këtë rast ai nuk pranoi dhe u largua në drejtim të shteti të vet me një fjalë personit që e solli të investojë këtu “si jetoni ju në këtë shtet” ky është një rastë të cilën e njoh vet por sa ka kështu raste të tjera mund të konstatohet se ka plot, lëre se nuk i ndihmojnë qytetarët por as nuk pranojnë ndihmesa ku qëllimi i vetëm është që personat në krye të bëhen të pasur e për qytetarët është bërë modë d.m.th ka rrugëdalje ti marrin valixhet le të punojnë jashtë vendit. Largimi nga vendi don të thotë njëkohësisht largimi nga familja, nga fëmijët bashkëshortja prindërit gjë që sjell në një dhembëshuri shpirtërore ku më vonë ky largim sjell në divorce sepse i larguari është martuar martesë mund të ketë qenë si rrjedhojë e dokumentave për të punuar, në shtetin ku është strehuar ku më pas nga jetesa me një grua tjetër ka harruar familjen e vet të lënë nga vendi ku është larguar dhe si pasojë e gjithë kësaj kanë pësuar familja respektivshisht fëmijët ku në të shumtën e rastave ka ardhur ku fëmijët e lënë nga njëri prind të kenë kryer veprime kriminale.

Në vazhdim do të paraqesim tabelën e marrë nga enti statistikorë i R.M në lidhje me papunësinë dhe sa është përqindja njëkohësisht evoluimin se si në shtetin tonë ka qenë numëri i të papunësuarve.

Viti	Gjithësejt	Mashkull	Femra	Përqindja	Të rinjë 15-24 vjet
2013	277 219	166 294	110 925	29	51 736
2014	268 809	160 316	108 493	28	50 736
2015	248 933	154 592	94 341	26.1	43 792
2016	225 049	141 578	83 471	23.7	41 451
2017	213 564	132 512	81 052	22.4	40 799
2018	198 569	124 054	74 515	20.7	37 472

Të dhëna nga enti statistikor i R.M⁶⁸

Nga tabela e marrë nga enti statistikor i R.M shohim se nga 2013 deri në 2018 kemi vetëm ulje të papunësisë. Viti 2018 ka qenë përqindja më e madhe me 29 përqind përderisa viti 2013 në 20 përqind, përderisa tek të rinjtë e moshës 15-24 vjet viti 2013 numri i të papunësuarve është në 50 përqind nga numri i përgjithshëm i të rinjëve në R.M.

⁶⁸ www.stat.gov.mk

Në bazë të tabelës së lartpërmendur mund të konstatojmë se ky zvogëlim i të papunësarve nuk është si rezultat i ndërmarjes së ndonjë mase për uljen e papunësisë nga ana e shtetit, por si rezultat i madh i largimit të shtetasve tanë në drejtim të Gjermanisë respektivshisht një numër i madh i të rinjëve në dy apo tre vitet lëvizin në drejtim të shtetave tjera ku akoma shumë e më shumë të rinjë presin viza pune.

4.1.3 Jetesa në kushtet e vështira

Jetesa në kushte të vështira një tjetër faktorë i rëndësishëm për kryerjen e veprave penale në përgjithësi e në veçanti kryerjen e veprave penale kundër pasurisë. Me faktorin në fjalë nëkuptojmë jetësën në një banesë apo shtëpi me kushte shumë të vështira si p.sh shtëpi apo banesë e cila është duke u rrënuar, me mungesë të ngrohjes, apo të ujit, mos plotësimi i kushteve elementare ndaj fëmijëve si egzistenca, veshëmbathja, ushqimi ose shtëpia jo e mbrojtur nga kohët kur janë me shi apo borë, apo marrja pjesë e më shumë anëtarëve, që të gjithë këto paraqesin ndikim në kryerjen e veprimeve kriminale.

Problemi për banesë të re mungesa e zgjedhjes së çështjes së banimit luan rol të madh në procesin e emigrimit të popullsisë me lëvizje masovike prej fshatrave drejt qyteteve, si pasojë e këtyre lëvizjeve krijohet mungesë e hapërisës banesore, dhe për këtë arsye me qëllim që të bëhet një zgjedhje adekuate të problemit në fjalë ndodhë që të bëhet ngritja e pallatit fjala është për shtimin e një kati më tepër pa kurrëfarë plani urbanistik, ku më pas vjen deri në kundërthënie mes qytetarëve, nga studimet e bëra nëpër shumë vende të botës migrimi i popullsisë prej vendeve fshat, qytetë ose prej një vendi të pa zhvilluar në një vend më të zhvilluar paraqiten veprime kriminale për shkak mos përshtajtes me qytetarë të tjerë ku rol të madh luan dallimi në gjendjen ekonomike kriza e banimit, familjet e ardhura në një vend tjetër hasen me probleme të ndyshme p.sh me punësimin, shkollimin e fëmijëve që të gjithë këto sjellin deri në shuarjen e një familje.⁶⁹

Do të ndalemi pak dhe të analizojmë rastin kur në një shtëpi jetojnë më shumë anëtarë, gjë që në të kaluarën ka qenë mjaftë e përhapur, e pranishme edhe sot por jo si më parë sidomos nëpër fshatra. Jetesa e më shumë anëtarëve njëkohësisht duke mos i plotësuar kushtet elementare sjell në konflikte të ndryshme bie fjala kur në një shtëpi apo banesë jetojnë dy ose më shumë vllazër ku gjithësecili ka krijuar familjen e vet dhe jetesa në një shtëpi të tillë, normalishtë se ka konflikte, konflikte të cilat sjellin deri tek veprimet kriminale, si pasojë e mos plotësimit të kushteve vjen deri tek konflikti i shkurorëzimit të bashkëshortëve nga ky shkurorëzim pastaj pason lënia e fëmijëve ku ata e kanë të vështirë të përballen me divorcin e prindërve gjë që i çon deri në prijen e cigareve alkoolit, drogës, ikje nga shkolla si dhe shumë veprime tjera.

⁶⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq 251-252

Ose kur është fjala tek të miturit jetesa në një shtëpi të tillë nuk ju pëlqen pasi që gjatë kalimit të ditës në shkollë kalojnë orë të tëra me shokët apo shoqet e klasës ku mund të hasin që një shokë të shkojnë me biçiklet, tjetri me iPad apo celular modern siç i quajnë smartphone që të gjitha këto sjellin gjendje lakmie që edhe ata të gëzojnë diçka të tillë, të gjitha këto sjellin deri në braktisjen e familjeve të tyre duke kërkuar zgjidhje për kushte më të mira, braktisja e cila pastaj mund të sjellë në krijimin e një shoqërie të re, të cilët veçse më janë delikuent që kryejnë vepra penale të vjedhjes, që nënkuptojmë edhe këta të adoptuar në këtë shoqëri do të bëhen kryerës.

Apo në këndvështrimin tjetër pamundësia e prindit për plotësimin e kushteve për një jetesë më të mirë për një shtëpi më të mirë duke kërkuar rrugëdalje dhe duke qenë i mendimit se gjithë jetën kam qenë në kësi kushte skam çfarë të humbë ndodh që edhe ai të jetë kryerës i veprimeve të ndryshme kriminale si p.sh shitja e drogës vjedhje etj etj.

Vlen të theksohet se në kryerjen e veprimeve kriminale nuk është e pranishme vetëm kryerja e veprave kriminale e fëmijëve që jetojnë në kushtet e lartpërmendura por kemi raste kur kryerës janë edhe nga ana e të miturve që jetojnë në kushte shumë të mira me anëtarë shumë më pak fjala është tek fëmijet që janë shumë të lazuruar i posedojnë të gjitha kushtet apo janë siç njihen si fëmijë të hasretit.

Kryerja e veprimeve kriminale tek këto fëmijë vjen krejt si rezultat i jo edukimit nga ana e prindërve pasi që siç thamë ata më i posedojnë të gjitha kushtet e tyre, gjithashtu këta fëmijë me gjithë kushtet e poseduara ata kërkojnë akoma më shumë gjëra që nuk i kanë të tjerët duke i parë nëpër rjetet e internetit të njejtat i duan edhe për vete, shpesh herë nga lajrimi i tepërt kemi shumë raste kur të rinjtë në fjalë nga familjarë të pasur duke mos i qortuar prindërit për asgjë vijnë deri në konsumimin e drogës dhe alkoolit për të cilat do të flasim në vazhdim.

4.1.4 Alkoolizmi dhe Narkomania

Alkoolizmi dhe narkomania si faktorë në kryerjen e veprave penale respektivisht veprës penale kundër pasurisë mjaftë e përhapur në të gjithë botën ashtu edhe tek ne. Që të dyja ndikojnë mjaftë rëndësishëm deri në kryerjen e veprimeve kriminale, poashtu faktorët në fjalë vlen të potencojmë se janë mjaftë të ndërlidhur me faktorët e më sipër fjala vjen p.sh tek faktori ekonomik, i papunësisë, e kështu me radhë për arsye se nga faktorët e më sipër jo në shumicën e rasteve po në disa raste vjen deri tek konsumimi i alkoolit apo i narkomanisë konkretisht fjala bie, p.sh rasti kur një person me ekonomi të dobët ose i papunësuar mundet të kalojë në derpsion në mërzitje të madhe duke kërkuar zgjidhje për problemin që ka dhe për mos zgjidhjen e të njejtës bëhet konsumues i njërës nga faktorët në fjalë. Në vazhdimë do të flasim për të dy faktorët veç e veç.

4.1.4.1 Alkooli

Alkooli një pije mjaftë e përhapur në botën bashkëkohore, pije e cila me substancat e saj në rastë teprimi sjell deri në dehje ku më pas pëson dëme të tjera familjare, ekonomike, si dhe veprime kriminale.

Alkooli për sa i përket literaturës kriminologjike konsiderohet një shkaktarë që luan rol mjaftë të madh në kryerjen e veprave penale në përgjithësi e në veçanti kur konsumues të saj janë personat kronik, domethënë ata të cilët e konsumojnë vazhdimisht madje as nuk mundë të rrinë pa të. E njejtja si pije poashtu shkakton edhe probleme shumë të mëdhaja jo vetëm për konsumuesin si probleme fizike, psiqike por edhe rrethin ku jeton konsumesi si : familja, shoqëria, etj.

Alkooli siç potencuam më lartë si një pije mjaftë e dëmshme për vetë konsumuesin dhe më gjërë në vazhdim do të ndalemi pak të analizojmë rolin e konsumuesit kronik dhe sjelljet e tijë në raport me familjen dhe kryerjen e veprave penale të pasurisë. Pamvarësishtë shkaqeve nga se ka ardhë deri në konsumues kronik me konsumimin e të njejtës lëre se pikë së pari i shkakton dëm vetës por akoma dëmin më të madh ja shton familjes bashkëshortes, prindërve, ku akoma më keq e pësojnë nëse personi i cili e konsumon të njejtën ka edhe fëmijë.

Me pirjen e alkoolit personi humbë karakterin e tijë shëndrohet në një njeri tjetër shumicën e rasteve renacak, nëse është i punësuar humbë punën akoma më keq ndodhë që të shkurorëzohet me bashkëshorten, me çrast shtrohet pyetja çdo ndodhë me fëmijët, fëmijë të cilët nga divorci i prindërve mundet që të bien pre e shumë veprimeve kriminale. Pra siç shohim se personi i cili është kronik shkatëron një familje të tërë.

Për sa i përket raportit të personit të mvarur nga alkooli me sjelljet kriminale pikë së pari konsumuesi kronik nuk është në gjendje që të vozis makinën sepse rrezikon që ti marrë jetën ndonjë tjetri i cili është në rrugën e vet apo ndonjë kalimtari të pafajshëm ku edhe shumë lajme nëpër rrjete sociale, ose në kanale të ndryshme televizive ndëgjojmë për kryerjen e veprave penale nga një njeri i dehur.

Pastaj për pirjen e të njejtës nevojiten të holla të holla të cilët mund ti kesh për një periudhë por shtrohet pyetja pasi që ske para ske të ardhura ske nga se tët vinë çdo ndodhë pastaj?.

Në këtë rastë vjen deri tek vjedhja do të kryej veprën penale qoftë grabitjes, vjedhjes grabitqare apo vjedhjes së rëndomtë me qëllim që të krijojë ca të holla që të ketë edhe për nesër për të pirë.

Pra shohim ndikimin e madhë të alkoolit në çregullimet familjare si dhe sjellejt e një kroniku në raport me sjelljet devijante.

Alkooli një sëmundje mjaftë e përhapur në shtetin tonë ku konsumes nuk janë vetëm gjinia mashkullore por tani në këtë kohë edhe gjinia femore e konsumon me të madhe, ku nuk përjashtohen as të miturit.

Femra si alkooliste jo kronike por edhe akute mund të sjell akoma probleme më të mëdhaja familjare se sa mashkulli në vendin tonë ndoshta jo e drejtë por që e hasim. Përshembull të themi një grua me status e martuar me shoqëri e ftuar në një party të ndryshëm apo kalimi i një nate në ndonje kafene të ndryshme ndodh që me prijen e një sasive të kaloj në dehje, dehje e cila sjell deri në imoralitet me një burrë tjetër gjë që menjëher sjell deri në shkatërrimin e saj si dhe familjes.

Me qëllim të parandalimit të kësaj sëmundje ku konsumues janë të mitur, burra dhe grua nëpër shumë vende të ndryshme të botës janë bërë përpjekje për parandalimin e të njejtës, ku insistohet në ndërmarjen e masave medicinale shëruese në fazë të parë e më pas masave administrative juridike, gjegjësisht insistohet në vendosjen e regullave të ashpra të trafikut si dhe në kriteret për dhënien e lejes së vozitjes, gjithashtu janë ndërmarë masa që edhe nëpër lokale ku përdoret alkooli e njejta mos tu jepet personave nën 18 vjeç. Në disa vende të botës është paraparë si masë e detyrueshme shërimi i kornikëve nëpër ente të caktuara⁷⁰.

Të gjitha këto masa të lartpërmenduar të cilat zbatohen në vende të jashtëme tek vendi jon ngelen vetëm për tu dëshiruar, jemi vet dëshmitar se çfar pasojash ka nëse në europë të ndalon një policë rrugor dhe të kap me alkool dhe se çfar pasojash ka në vendin tonë.

Për sa i përket mënyrës së sanksionimit që të dyjave si allkolizmit ashtu edhe narkomanisë sipas kodit penal të shtetit tonë do të flasim në vazhdim pasi të kemi përfunduar me elaborimin e narkomanisë.

⁷⁰ Xhorgje Ignjatoviç, 2008 Beograd, shih nga, fq 250-255

4.1.4.2 Narkomania

Krahas alkoolit narkomania konsiderohet një problematikë shumë më e madhe se alkooli në kryrjen e veprave penale si dhe në çregullimet e raporteve familjare. Për konsumimin e të njejtës nevojiten shumë më shumë të holla se sa në konsumimin e alkoolit, faktori në fjalë një problematikë mjaftë e përhapur nëpër të gjithë botën përfshirë edhe vendin tonë, ku lëndët narkotike të ndryshme si hashishi, kokaina, heroina, por më konkretisht hashishi përdoret me të madhe në vendin tonë tek të rinjtë, arsyeja pse kjo lëndë narkotike përdoret më shumë është shkaku se është më e lirë, por kjo nuk do të thotë se lëndët tjera nuk përdoren.

Thënë më ndryshe më është bërë modë pirja e lëndëve narkotike madje nëpër shumë vende të ndryshme është edhe legalizuar si p.sh në Hollandë, Çeki si dhe disa vende tjera të botës, me çka në vendin tonë është rreptësisht e ndaluar por në përditëshmëri mjaftë e konsumuar.

Sa i përket asaj se çka nënkuptojmë me të njejtën ka shumë përkufizime të ndryshme sipas literaturave të ndryshme andaj narkomaninë do ta përkufizojmë si lëndë e cila me substancat e saj narkotike krijon varësi, varësi e cila më pas sjellë në probleme mjaftë të ndryshme si ato: shëndetësore, psiqike, ekonomike ku më gjerësishtë do të flasim në vazhdim. Për dallim nga alkooli kur konsumues të së njejtës mund të jenë dhe njerëz me ekonomi të dobët përderisa tek narkomania ndëron biseda pasi sipas studimeve të shumëta është vërejtur se konsumues të lëndëve narkotike janë të pasurit ndërsa tek të miturit në shumicën e rasteve janë ata fëmijë që konsiderohen të hasretit. Përndryshe nga alkooli narkomania krijon një varësi shumë të madhe ku personit i nevojitet dozë e përditshme dozë e cila e me përsëritjen e së njejtës sjell në përkeqësimin e ekonomisë dhe me përkeqësimin e së njejtës, apo edhe nevoja apo varësia për sigurimin e të njejtës nënkuptojmë që kryerja e vejdhjes është në prag.

Në rastë se nuk posedon financa të mjaftuara për sigurimin e lëndës narkotike konsumuesi me qëllim që të sigurojë shumën e të hollave do të kryejë veprën e vjedhjes, nëse jo veprën e vjedhjes do të ushtroj dhunë tek familjarët dhuna e cila do të lërë trauma tek fëmijët, ku fëmijët nëse janë në shkollë do të jenë në depresion pasi që me ta nuk do të afrohet asnjë nga shokët apo shoqet e klasës pasi mund të kenë njohuri për prindin e shokut të klasës që është konsumues i substancave narkotike me çrast fëmija i pafajshëm ngelet në vetmi d.m.th i pa shoqëruar, vetmi e cila më pas pëson në rethana të ndryshme si ikje nga shtëpia, shkolla dhe shoqërimi me persona të ndryshëm ku ndonjëri nga shoqëria e re mund të jetë narkomanë dhe kështu i tillë përfundon edhe ai, dhe pastaj me radhë vazhdojnë probleme të një pas njëshme.

Nëse analizojmë atë legalizimin që thamë më parë që është e legalizuar në disa shtete dhe tek shteti jonë jo shtrihet pyetja se a duhet që edhe tek ne e njëjta të legalizohet?.

Në bazë të asaj se ky fenomen është në rritje të madhe ku gati se çdo ditë nëpër rrjete sociale si dhe kanale televizive të ndryshme ndëgjojmë për kapjen e ndonjë personi me drogë apo përfundimin në ente të caktuara të ndonjë personi si pasojë e konsumit të tepëruar të lëndës narkotike, ose shprehja e dhunës ndaj familjarëve nga personi të cilin e ka kapluar kriza e drogës, andaj mund të konstatojmë se edhe tek ne e njëjta duhet të legalizohet, për vetëm një arsye dhe ajo arsye është se blerja e çfarëdo malli si pasojë e legalizimit do të kishte një kontrollë në atë se shitësi çfarë ofron sepse gjatë një bisede të zhvilluar me një person që ka përfunduar në spitalë nga hashashi në një fshat të rethinës së Gostivarit, i njëjti tregon arsyen se pse ka përfunduar në spitalë, njëkohësisht personi në fjalë nuk është narkomanë por lëndën narkotike të hashashit e ka provuar për herë të parë dhe arsyeja e përfundimit në spitalë ka qenë në bazë të diagnozës së dhënë nga mjeku se lënda ka përmbajtur, gjëra mjaftë të dëmshme për shëndetin bile që skanë pas të bëje me hashshin, apo ndonjë lëndë tjetër narkotike, andaj në rastë legalizimi nuk do të thotë që ajo nuk do shitet në të zezë tregtia ilegale do të egzistonte përsëri por njerëzit që do ta kenin mundësinë për të blerë të njëjtën më mirë do e blenin një mallë të kontrolluar fjala bie njëjtë si ke pakot e cigareve ku një duhanxhiu nëse i ofrohet një pako cigare me përmbajtjen firmës së vet, dhe me markën nga pas të shtetit dhe nëse i ofrohet një pako pa mark pa firmë cila do të jetë zgjidhja normalisht do të blente mallin e kontrolluar për shkak besimit.

Sa i përket narkomanisë tek individët që e konsumojnë drogën, kanabisin, morfoinën apo çfarë do lloji tjetër me substancat e saj narkotike shkakton sëmundje të ndryshme psikike fizike. Kështu që nëse e marrim se çka është më e mirë për shoqërinë dhe më gjërë atëherë normalisht se më e mirë do ishte jo konsumiti të së njëjtës por pasi që e njëjta konsumohet atëherë më e mirë do ishte legalizimi. Në vazhdim do të paraqes një rastë studimi në një fshat të Gostivarit i cili filloi me konsumimin e një lënde narkotike dhe përfundimin e tijë.

Personi me iniciale të mbrojtura i rjedhur nga një familje e pasur me biznesë në perëndim shoqërohet në një shoqëri të degraduar të cilët më pas e degradojnë edhe këtë i cili pa hezitur xhepat plot i futet dhe ki narkomanisë me lloj lloj malli të ofruar, ku më pas pësoi deri në degradimin e tij total ku i lindën probleme të mëdhaja psikike fizike familjare si përshembull futja në borxhe, në kamata të ndryshme vetëm e vetëm që të siguroi mallin e cila më vonë i pësoi deri në mjekim psikiatrik në perëndim i cili sot e kësaj dite nuk mund të stabilizohet, sa i përket prindërve të tijë u kushtoi shitja e disa pronave me qëllim që ty shlyejnë borxhet e të birrit të vet, e gjithë kjo nga konsumimi i narkomanisë dhe nga përmbajtja e mallrave të ndryshëm, mjaftë të dëmshme për trupin e njeriut.

Apo rasti tjetër burrë i martuar me fëmijë njëjtë në fshatrat e Gostivarit si pasojë e varrësisë së narkomanisë shet të gjithë arrin e bashkëshortës së tijë pastaj paraqet dhe dhunë të herë pas herëshme ndaj bashkëshortës ose ndaj fëmijëve të tij për arsye se nuk

mund të siguronte lëndë narkotike tek ky rast karakteristike është se më keq e pësoi fëmija i cili duke u futur ta mbroj nënën e vet nga dhuna e ushtruar e babait drejt nënës, fëmija reth moshës 12 vjeç pëson grusht që rezultoi me lëndim të rëndë truporë.

Dhe si përfundim mund të konkludojmë se narkomanija në shtetin tonë sjell mjaftë probleme ose themi bukalisht shetasit tanë nuk e kanë hallin qoftë aspektin socialë apo juridikë sepse edhe shteti pak masa ndërmerë, ku biles edhe shteti në shumicën rasteve nga lëndët narkotike të kapura ndodh që vet personat zyrtarë bëjnë kontrabandë e shesin të njejtën me qëllim përfitimi të menjëherëshëm ose ndodh lidhin marveshje me personin që e kanë kapur duke i ofruar mundësi futjes së mallit por pasi ta shesë të nejtën parat e fituara ti ndajnë, në këtë rast shohim bashkëpunimin në mes një kontrabandi dhe personi zyrtarë.

Se si trajtohen këta persona të mvarur nga alkooli dhe narkomania në vazdhim do ta elaborojmë sanksionin që marrin sipas K.P.M edhe atë:

Sipas K.P.M personat e mvarur nga alkooli apo narkomania u shqiptohet sanksioni kryesor ose alternativ po përshkak të varrësisë nga njëra prej akoolit ose lëndëve narkotike, së bashku me dënimin kryesorë u shqiptohet edhe masa e sigurisë. Qëllimi i masave të sigurisë është që nëpërmjet këtyre masave kryerësi të risocializohet si dhe të ndikojë që të mos bëhet në të ardhmen recidiv. Sipa K.P.M llojet e masave të sigurisë janë:

1. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në instuticion shëndetësorë;
2. Mejkimi i detyrueshëm psikiatrik në liri;
3. Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe i Narkomanëve⁷¹.

E para dhe e dyta u shqiptohen personave që kanë probleme psiqike që janë të pa përgjegjshëm ose me përgjegjësi esenciale të zvogëluar për të cilat do të flasim më poshtë ndërsa e treta u shqiptohet siç potencuam personave të mvarur nga alkooli dhe narkomania, kur gjykata dyshon se mund të ketë rrezik që edhe në të ardhmen të kryejë veprë penale, sa i përket varrësisë nevojitet vërtetimi mjekësorë.

Për tu shqiptuar kjo lloj mase me doemos nevojitet egzsitimi i lidhjes kauzale mes veprës së kryer dhe varrëshmërisë nga droga, apo alkooli pasi që vepra mund të jetë e kryer edhe në gjendje të rastit *actio libera in causa* ku personat e sjellin me dashje veten në mënyrë të papërgjegjshme me qëllim që të kryejn vepra penale, pra medoemos nevojitet që të egzistojë varrëshmëria⁷². Kjo masë gjithashtu është masë e karakterit medicinal sepse konsiston në trajtimin medicinal të kryersit si dhe të çrënjoset shprehia e njërës nga alkooli apo droga.

Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve apo narkomanëve shqiptohet së bashku me ndonjërin nga dënimet kryesore apo sekondare dhe relizohet në ent shëndetësorë ose

⁷¹ Afrim Osmani, Kodi Penal i R.M, Shkup2015, fq84

⁷² Nga ligjerat e studimve deri dhe post diplomike nga e drejta penale ligjëruar nga Ismail Zejneli.

ndonjë ent tjetër të specializuar dhe koha e kaluar në ent i konsiderohet njejtë si dënim konkretisht nëse është dënuar me dënim me burg për aq sa zgjat dënimi me burg të njejtën nuk do ta kaloj në burg por do të kaloj në ent të caktuar. Kur masa e mjekimit është e shqiptuar me ndonjë dënim tjetër si: dënimin me burg ose dënim me kusht, dënimi me kusht në mbikëqyrje të intensifikuar, ose të ndonjë dënimi tjetër, kohëzgjatja është e kufizuar më shumë se dy vjet⁷³.

Nga e gjithë kjo mund të konkludojmë se qëllimi i masave të sigurisë respektivisht mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve konsiston në:

- Luftimin e kriminalitetit;
- Menjanimin e kushteve dhe gjendjeve që ndikojnë në recedivizëm;
- Ofrimi i ndihmës ndaj kryerësit në shërimin e tij çrënjësor e shprehisë së mvarur nga alkooli apo narkomania si dhe kthimi në një jetë normale⁷⁴.

4.2 FAKTORËT SUBJEKTIV

Sado që faktorët e jashtëm të jenë të rëndësishëm në paraqitjen e sjelljeve kriminale, dukuria e kriminalitetit, dhe shkaqet e saj nuk mund të shpjegohen pa analizimin dhe ndriçimin e faktorëve të brendshëm. Pasi që faktorët objektiv i dedikohen personalitetit të kryerësit, një rethanë krejt ndryshe nga faktorët objektiv, por që janë të ndërlidhura në mes veti. Kur jemi tek faktorët subjektiv jo vetëm se studjohet personaliteti, por në thkasë të veçantë veçohet jeta e kryerësit në aspektin biopsiçik, dhe psiçik⁷⁵.

Në vazhdim do të përqendrohemi në disa nga faktorët subjektiv, faktorë që kanë ndikim mjaftë të rëndësishëm në kryerjen e veprave kirminale për të cilët kanë folur edhe sociolog, psikolog të famshëm si Cezaro Lombrozo, Enriko Ferri, Emir Dirkem etj. Andaj si faktor subjektiv gjatë këti hulumtimi janë marrë parasysh:

- Vetitë psiçike të personalitetit të kryerësve të veprave penale të Grabitjes dhe Vjedhjes grabitqare;
- Zhvillimi dhe niveli i intelegjencës të kryerësve të veprave penale të Grabitjes dhe Vjedhjes grabitqare;
- Qëllimet dhe motivet e kryerësve të veprave në fjalë dhe ;
- Çregullimet mentale.

⁷³ Natasha Pelivanova, Merki na bezbednost od medicinski karakter, Shkup 1996

⁷⁴ Bajram Ukaj, dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006, fq.279-291

⁷⁵ Crime and Criminology ninth editon, Sue Titus Reid, USA 200 fq 85-88

4.2. Vetitë psiqike të personalitetit t kryerësve të veprave penale të Grabitjes dhe Vjedhjes grabitqare

Personaliteti i njeriut është i ndërtuar në baza psiqike dhe biologjike, që të dy këto komponente krahas faktorëve objektiv si ekonomia, papunësia që folëm më parë kanë rëndësi në zhvillimin e personalitetit të njeriut. Si veti dhe cilësi psiqike të cilat e formojnë dhe kategorizojnë një individë janë: tempamenti, intelegjenca, emocionet, shprehitë, motivet etj⁷⁶.

Ekzistojnë studime të shumëta psikologjike mbi personalitetin dhe vetitë psiqike të njeriut, në mënyrë që të shpjegohet burimi i disa sjelljeve devijante, andaj do të theksojmë teorinë e psikoanalizës nga autori Helfgot ku në veprën e tij Criminal Psihology flet për Frojdin ku thkson se personaliteti i njeriut kalon nëpër disa faza dhe se individi personalitetin e e krijon në moshë mjaftë të re edhe atë që në moshën 5 vjeç⁷⁷.

Sa u përket vetive psiqike është mjaftë me rëndësi të studjohet jetesa e individit që në fëmijëri, pasi që me një studim të tillë më lehtë mundet të arrimë në përfudnimin shkakë-faktorë, në kryerjen e sjelljeve devijante. Sepse një person i rritur në një familje të degraduar familje ku është ushtruar dhunë psiqike apo fizike nodhë që edhe ai të ushtrojë dhunë ndaj ndonjë personi tjetër p.sh një person më parë i viktimizuar nga dhuna psiqike me kalimin e kohës kalon në rotacion që nënkupton që i viktimizuari shpreh dhunë psiqike ndaj një tjetri.

Personaliteti i njeriut respektivisht bota shpirtërore është mjaftë komplekse pasi që sjelljet e tyre nuk mund të kuptohen që në shikim të parë sepse njeriu si qenie psiqike, bartë një vargë prej cilësive dhe vetive të natyrës së brendshme të cilat mundë të vërehen veç veç, e në realitet ato cilësi e përbëjnë një tërësi që quhet personalitet⁷⁸.

⁷⁶ Edmond Dragoti, Psikologia e krimit, Tiranë 2011 shih faqen 105-145

⁷⁷ Jacqueline. B. Helfgott, Criminal Psychology, USA 2013, faqe, 65, 66.

⁷⁸ Ragip Halili Viktimologjia Prishtinë 2011 fq 121-122.

4.2.2 Zhvillimi dhe niveli i intelegjencës të kryerësve të veprave penale të Grabitjes dhe Vjedhjes grabitqare

Kur flitet për intelegjencën si faktorë në kryerjen e veprimeve kriminale logjikisht është më se normale që kryerës të sjelljeve devijante të jenë personat me intelegjencë të ulët, mirëpo në jetën e përditëshme nuk mund të menjanohet fakti se edhe personat me intelegjencë të lartë janë kryerës të veprave penale të ndryshme. Intelegjenca luan rol mjaftë të rëndësishëm në zhvillimin, formimin, si dhe dhe adoptimin e njeriut në shoqëri. Pasi që individi me intelegjencë të lartë mendon shumë më shëndoshë se ndonjë person tjetër me intelegjencë më të ulët.

Për sa i përket mënyrës së kryerjes së veprave penale në përgjithësi, e në veçanti veprave penale kundër pasurisë vlen të potencojmë se pjesa dërmuese e kryerësve janë personat me intelegjencë të ulët, por nëse analizojmë pjesën tjetër persona me intelegjencë të lartë ata janë akoma kryerës më të rrezikshëm si kryerës të veprave penale pasi që ndodh që ndonjë vjedhje kryhet në mënyrë spektakolare, si në mënyrën e përgaditjes së vjedhjes, poashtu edhe në realizimin e të njejtës fjala bie përshembull vjedhja e ndonjë banke ku në të marrin pjesë persona me intelegjencë të zhvilluar si policë, apo ndonjë oficer , ose ndonjë person tjetër zyrtarë, tek të cilët edhe zbardhja e rastit, gjetja e provave është mjaftë e vështirë.

Sa i përket raportit mes personave me intelegjencë të ulët dhe të lartë del se të dy kryejnë sjellje devijante vetëm se dallimi konsistonë në atë se personat me intelegjencë të lartë janë më tepër si organizues parashikues përgatitin terrenin ndërsa këta me intelegjencë të ulët zbatojnë urdhërin e çojnë në vend.

Intelegjenca në psikologji përkufizohet si aftësi e të menduarit, dhe zgjedhjes së problemeve, pra ajo është tërësi e vetëdijes dhe aftësive të personalitetit, në literaturë përmenden disa faktorë të cilët e përcaktojnë intelegjencën e personit. Psikologu amerikan Luis Terston përmend shtatë faktorë të intelegjencës:

- Të kuptuarit verbal apo aftësia e të folurit;
- Aftësia numerike operimi me numëra;
- Faktori hapësinorë e cila ndërlihet me mbajtjen mend të ndodhive apo ngjarjeve;
- Memorim që përfshinë aftësinë për të memorizuar shpejtë;
- Perceptimi i hapsirës sendeve në rethin që jeton;
- Faktori i arsytimit që kërkojnë që një subjekt të zbulojë një regull ose parim të përfshirë në një seri ose gurpe letrash;
- Interpretimin e fjalive me kuptim të gjatë në kuptime të shkurta⁷⁹.

⁷⁹ http://www.bhel.com/dynamic_files/press_files/pdf/pdf_14-Mar-2005.pdf

4.2.4 Qëllimet dhe motivet e kryerësve të veprave penale Grabitja dhe Vjedhja grabitqare

Në kryerjen e sjelljeve devijante faktorë kryesorë është qëllimi dhe motivi, ku të njëjtat mund të vinë si pasojë e qëllimeve apo motiveve të ndryshme të cilat kanë lujatur rol në kryerjen e veprimeve kriminale.

Motivet janë cilësi dhe veti të personalitetit, ndërsa aktiviteti, veprimet, dhe angazhimet e individit zhvillohen në bazë të shtytjeve dhe nxitjeve të brendëshme. Pikërisht motivet janë fuqi që nxisin që një individë të jetë aktiv. Motivët përbëhen prej elementit të **vetëdijes** dhe **vullnetit**. Për sa i përket ndarjes së motiveve si në psikologji ashtu edhe në kriminologji motivet ndahen në: biologjike, dhe sociale, ose primare, dhe sekondare ndërkaqë disa autorë motivet i ndajnë në motive të lindura, dhe të fituara. **Sa i përket motiveve biologjike** këta motive sipas autorëve janë në personalitetin e personit që në lindje si p.sh motivi për ushqim, për shuarjen e etjes, për gjumë etj. Motivët biologjike dhe raporti i tyre me sjelljet kriminale është mjaftë i përhapur fjala bie për persona të cilat kryejnë veprat penale për shkak motivit seksual apo material. **Motivët sociale** ndërkaqë ky motiv mjaftë i përhapur për të cilin kemi folur edhe në faktorët objektiv, motivet në fjalë janë forca nxitëse ku e shtynë një person në kryerjen e ndonjë veprë penale përshembull tek vjedhja ku motivi është pasurimi, sa i përket numrit të motiveve sociale është i madh por si më të rëndësishme janë: motivi për shoqërim, vetëpohim, i sigurisë, i firkës etj.⁸⁰

Ajo çka na interson neve është raporti i motivit me sjelljet kriminale, janë teori të shumëta nga autorë të ndryshëm që flasin për motivin si shkaktarë në kryerjen e sjelljeve kriminale por do të flas në lidhje me motivet në raport me sjelljet kriminale nga jeta e përditëshme pasi që të gjithë ne kemi motive të cilat na shtyejnë në ndërmarjen e ndonjë veprimi.

Pikë së pari do të analizojmë rastin kur ndonjë person e ka një motiv të cilën e realizon në mënyrë të plotë ka ndonjëri mesatarisht dhe ndonjëri fare. Që të gjithë ne sa zgjohemi kemi ndonjë motiv ndonjëri si të bëhet i pasur, tjetri ka motiv të emigroj, ndonjëri të punësohet e shumë raste të tjera. Por shtrohet pyetja çfarë ndodh me personin kur motivin apo qëllimin e vet nuk arrinë ta realizojë?.

Normalisht se personaliteti i njerëzve në përgjithësi është i ndryshëm ndonjë pajtohet me fatin atë që e ka të shkruar mirëpo dikush kur dëshiron tja arrijë qëllimit duke u motivuar me bindje të madhe dhe të njejtën nuk e realizon ndodh që të hyjë në një mërzitje të madhe, apo në një nervozë, të cilat më pas për të relizuar qëllimin kryenë ndonjë veprim kriminal.

⁸⁰ Shih Ragip Halili Kriminologji, Prishtinë fq 353- 355

Bazuar në tërësi mundë të konludojmë se faktorët objektiv u paraprijnë motiveve si përshmebull rasti i alkoolit, ku alkooli si faktorë i jashtëm nëpërmjet të cilit aktivizohen motivet e brendshme p.sh personi i mvarur nga alkooli, apo narkomanija që të ralizojë blerjen e së njejtës duke mos patur financa personale i paraqitet motivi për vjedhje të ndonjë sendi me vlerë vetëm e vetëm që të arrijë deri në konsumimin e alkoolit apo drogës.

Sa i përket varfërisë si faktorë i jashtëm një person i varfër normalisht se në mendjen e tij qëndron mendimi se si të dalë nga varfëria, ose si të siguroj ushqim, ose egzistencën për familjen e vet, ku si qëllim apo motiv të vetëm do të shoh një rrugëdalje e ajo rrugëdalje quhet kryerja e veprës penale të vjedhjes pa marë parasysh a grabijte, vjedhje grabitqare, vjedhje e rëndomtë, ose e rëndë. Shohim një raportë mjaftë të lidhur të faktorëve të jashtëm me motivet e njeriut.

Është me rëndësi të filet për motivin edhe në legjislacionin penale pasi që motivi paraqitet si komponentë ku me egzistimin e saj veprën penale do ta bëjë të cilësuar, apo formë më të rëndë në krahasim me veprën penale të rëndomtë.

Motivi në të drejtën penale ka ndikim të madh në përcaktimin e shkallës së fajësisë, dhe në shqiptimin e sanksionit, ndërkohë do të analizojmë veprën penale të vjedhjes së rëndë sipas K.P.M ku në nenin 236 paragrafin 5 vjedhja e rëndë konsiderohet se është kryer në kohë të zjarrit vërshimit ose ndonjë fatkeqësie tjetër, ose paragrafi 6 vjedhja e rëndë konsiderohet se është kryer nëse është shfrytëzuar pa aftësia e personit. Nëse anaizojmë këta 2 paragrafe të nenit 236 shihet qartë se kryerësit motivohen nga situata të ndryshme si paaftësia e tjetrit me çka në këtë rast ai motivohet se do të përfitojë nga paaftësia e tjetrit do të relizojë kryerjen vjedhjes në mënyrë më të lehtë sepse personi i paftë nuk do mund ti kundërpërgjigjet.

Apo kur është rasti i tërmeteve apo i vërshimeve siç kemi rastin e tanishëm në shetin fqinjë në Republikën e Shqipërisë që ndodhën trauma të mëdhaja nga tërmeti i shkakëtuar me çrast personat lëshuan vendbanimet e tyre duke i haruar nga trauma të themi sendet me vlerë vetëm e vetëm që të shpëtojnë nga ndonjë tërmet tjetër, gjë që solli deri në vjedhje të ndryshme të sendeve si flori, argjendë e shumë sende të tjera, ku dua të potencojë se në këtë rast personat kanë qenë të motivuar se më lehtë do të kryejnë marrjen e sendeve në fjalë pasi që kanë qenë të hapur dyert e hyrjeve apo shtëpijëve.

Në fund të gjithë pohimet lidhur me rëndësinë dhe llojin e motiveve mund të konstatojmë se ata paraqiten si faktorë të fuqishëm që çojnë deri në kryerjen e veprimeve kriminale, si dhe mjaftë të rëndësishëm në përcaktimin e personalitetit si dhe për të drejtën penale në shakllën e fajësisë si dhe në shqiptimin e dënimit.

4.2.4 Çregullimet Mentale

Vetë termi çregullim mental nënkuptonë persona të cilët vuajnë nga ndonjë çregullim mental si psikoza neuroza epilepsia apo ndonjë sëmundje tjetër. Në kohën e tanishme shumë autorë e studjojnë personat që vuajnë me ngecje mentale ose janë totalisht të sëmurë.

Kur si kryerës të veprës penale është personi me çregullime mentale atëherë sipas drejtës penale ai konsiderohet i papërgjegjshëm ose me përgjegjësi esenciale të zvogëluar, dhe kjo nuk do të thotë se nuk do të dënohen por ligjëvënsi parasheh si sanksion shqiptimin e masës së sigurimit.

Ku në nenin 12 të K.P.M është theksuar më detajisht edhe atë: *Nuk është i përgjegjshëm kryerësi i cili gjatë kohës së kryerjes së veprës penale nuk ka mundur ta kuptojë rëndësinë e veprës së vet apo nuk ka mundur t'i kontrollojë veprimet e veta për shkak të sëmundjes së përhershme apo të përkohshme shpirtërore, për shkak të çrregullimit të përhershëm shpirtëror ose të zhvillimit të ngecur shpirtëror (papërgjegjshmërisë) ose të pengesave tjera të rënda shpirtërore*⁸¹.

Nga ligji i sipërpërmendur shihet qartë se edhe pse këta persona kategorizohen si të papërgjegjshëm kjo nuk do të thotë se ata të lihen në liri që të bëhen recidivist. Andaj në nenin 63 flitet edhe për atë se çka ndodhë pas kryerjes së veprimi kriminal ku potencohet: *Kryerësit i cili ka bërë vepër penale në gjendje të papërgjegjshmërisë apo përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar, gjykata do t'i caktojë mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor, nëse vërteton se për shkak të asaj gjendjeje ka nevojë për mjekimin e tij dhe ruajtje në institucion të tillë*⁸².

Në literaturën kriminologjike si sëmundje mentale që zakonishtë kanë lidhje me veprime kriminale përmenden: Neurozat, Psikozat, dhe Psikopatitë. Në vazhdim ne nuk do të ndalemi ti elaburojmë këta tre sëmundje pasi që këta ndërlidhen me kryerjen e veprave penale të ndryshme, dhe pasi që tema ka të bëjë me Grabitjen dhe Vjedhjen grabitqare ne do të ndalemi tek sëmundja e Kleptomanisë si çregullim mental dhe faktorë subjektiv në kryerjen e veprës penale të vjedhjes pasi që Kleptomanët janë të çmendur pas vjedhjes ku më detajisht do të flasim më poshtë.

⁸¹ Neni 12 alineja 1 nga Kodi penal i RM-së Gazeta Zyrtare nr. 37/96

⁸² Neni 63 alineja 1 nga Kodi penal i RM-së, Gazeta Zyrtare nr. 37/96

4.2.4.1 Kleptomania

Fjala Kleptoman rjedh nga greqishtja e vjetër që do të thotë Kleptes - të vjedhësh, ndërsa mania – dëshira e tepëruar për të vjedhur. Në literatura të ndryshme ky fenomen shpjegohet si një sëmundje ku personi i vuajtur nga kjo sëmundje nuk mundë të kontrollojë instiktet pasi që për të ralizuar vjedhjen, vetëm për të vjedhur ndodh që vjedhin sende me shumë pakë vlerë⁸³.

Ndryshe nga faktorët më parë ku si rezultat i vjedhjes ishin disa faktorë si ai ekonomik, që folëm më lartë, ose papunësia, pra kishte ndonjë arsye e cila i preokoponte individët që për relizimin e të njejtës të kryenin veprën penale të vjedhjes tek kjo sëmundje karakteristike është se kryerësit nuk kryejnë veprën e vjedhjes si pasojë e ndonjë faktori por e kryejnë pa arsye ku madje është edhe krizë e personave VIP që janë të mvarur nga kjo sëmundje.

Kleptomania sa i përket moshës kush preket më shumë rezulton se më shpesh paraqitet tek adoleshentët dhe individët të moshës 30-50 vjeç, dhe akoma më karakteristike është ajo se gjinia femërore është më e prekur pra janë ato që e kryejnë më së shumti. Potencohet se gjithashtu kleptomanët vuajnë shumë nga stersi, depresia dhe për largimin e së njejtës ata çlirimin e shohin vetëm me kryerjen e vjedhjes pa pasur parasyshë se sendi i marrë çfarë vlere ka, kleptomanët janë shumë të fiksuar pas vjedhjes me çka janë bërë studime për parandalimin e saj por të cilat nuk kanë rezultuar me rezultat pozitiv ku janë mjekuar kleptoman të ndryshëm nëpër qendra të ndryshme shëndetsore me terapi të ndryshme por prap se prap pa rezultat, pasi që vjedhjen e kenë kryerë edhe në spital ku janë shtruar për shërim. Sipas disa psikologëve ata besojnë se ky çregullim është që në fëmijëri⁸⁴.

Duhet bërë dallimi në mes personave që vuajnë nga kleptomania dhe vjedhësit, pikë së pari kleptomanët vejdhejn e ralizojnë vetë duke mos u interesuar vlere e sendit përderisa vjedhësit e kryejnë për qëllim ekonomik si dhe në mënyrë të organizuar. Sipas psikoanalizës kleptomanët janë ata persona që vuajnë nga çregullimet mentale jo vetëm kaq por edhe patologji tjera të personaliteti si : paranoidët, piromanët dhe skizoidët. Karakteriskë tjetër sipas përkufizimit të psikoanalizës është ajo se kleptomanët e kuptojnë rëndësinë e veprës së kryer madje pas kryerjes të së njejtës kanë turp, ata pendohen por për heqejn e depresionit apo stersit ato medoemos kryejnë vjedhje⁸⁵.

⁸³ <https://books.google.mk/books?id=6SmSagAAQBAJ&printsec=frontcover&hl=mk#v=onepage&q&f=false>

⁸⁴ <http://www.pasqyre.al/te-gjiitha/te-pasura-por-hajdute-vip-at-qe-vuajne-nga-kleptomania/>

⁸⁵ <http://www.dusunenadamdergisi.org/ing/fArticledetails.aspx?MkID=1046>

Në vazhdim do të paraqesim persona të famshëm me gjenjde të mirë ekonomike por që janë kleptomani, ku karakteristikë është fakti siç potencuam se si kryerës janë personat që i përkasin gjinisë femrore, të cilat përkundër faktit se posedojnë shuma marmendëse janë në manin e vjedhjes.

Wynona Ryder një aktore e famshme Amerikane e cila në vitin 2000 pranoi yllin e saj në Hollywood, ndërkohësisht edhe një kleptomane e famshme e cila në vitin 2001 u xhirua duke vjedhur veshje të ndryshme në një dyqan me firmën e quajtur Beverly Hills, ku pas kryerjes së vjedhjes e njejta u dënua me 3 vjet liri me kusht, me gjobë diku te 4000 dollarë, si dhe 400 orë në shërbim të komunitetit, vjedhje e cila lujati shumë rolë më vonë në karrierën e saj.

Lindsay Lohan gjithashtu me profesione të shumëta si aktore, biznismene, modele, përkundër problemeve së vuajtes me substanca narkotike dhe alkool është xhiruar në vjedhjen e një varëse floriri e cila kushton diku reth 3000 dollarë.

Katty Perry këngëtarja e njohur me këngët e saj duke marë pjesë nëpër koncerte të ndryshme duke poseduar ekonomi të mirë gjatë një interviste e njejta pranon se vuan nga kleptomania dhe se në çdo hotel që qëndron ajo gjithmonë del me nga një jastëk të vjedhur.

Megan Fox aktorja e njohur e cila është zënë në vjedhje te një dyqani në Florida, duke vjedhur sende që e kënaqin si kozmetika. Karakteristikë në këtë rastë është ajo se dyqani në të cilën e ka kryerë veprën e vjedhjes edhe përkundër famës, apo pasurisë që mbizotronë pronari ia ka bërë rreptësishtë ndalesë që Megan Fox të mos futet në atë dyqan⁸⁶.

Pra në bazë të kësaj shohim se shumë persona të famshëm me pasuri të themi të madhe janë pre e kleptomanisë.

⁸⁶ <https://askopinion.com/famous-celebrities-who-are-kleptomaniac>

Përfundim dhe Rekomandime

Nga gjithë elaborimi i veprave penale të Grabitjes, dhe Vjedhjes grabitqare kuptuam përkufizimin e të njejtave sipas kodit penal të Maqedonisë, Kosovës, dhe Shqipërisë, mund të konkludojmë se sipas kodeve në fjalë veprat në fjalë përkufizoheshin tek të tre shtetet njejt ku vjedhja kryhej me përdorimin e dhunës me pak ndryshim në Kodin e Shqipërisë. Vjedhja siç kemi cekur në fillim një fenomen që ka egzistuar që në kohët e lashta prezente tani e tillë do jetë edhe në vazhdim.

Nga hulumtimi i bërë i aspekteve juridike penale në përgjithësi të veprave penale kundër pasurisë e në veçanti Grabitjes dhe Vjedhjes grabitaqre shihet qartë se me relizimin e ndonjëres nga këto verpime kriminale jo vetëm se atakohet pasuria, po edhe jeta dhe trupi i njeriut që llogaritet si veçori dalluese nga veprat tjera penale kundër pasurisë.

Pasi që Grabitja dhe Vjedhja grabitqare bëjnë pjesë tek veprat penale kundër pasurisë është me rëndësi të theksohet fakti se veprat penale kundër pasurisë, i hasim në dispozitat ligjore më të hershme të kodit penal të Maqedonisë p.sh në kodin penal të Republikës Socialiste të Maqedonisë të viteve 80, ku karakteristike është fakti që prej atëherë e deri më sot është përkufizimi i njejtë.

E potencojë këtë pasi që me ndryshimin evolutiv të shekullit XXI ku jemi vet dëshmitar të teknologjive të ndryshme, teknologji të cilat kanë luajtur ndikim të madh tek njerëzimi për të mirë ose për të keqë, konkretisht me zhvillimin e teknologjisë shihet qartë se edhe kryerja e një krimi në përgjithësi e në veçanti tek vepra penale e vjedhjes bëhet mjaft profesionale në mënyrë spektakolare ku në shumicën e rasteve organet kompetente për zbardhjen e rastit hasin mjaftë vështirësi duke arritur deri në atë se edhe kryerësit nuk i gjejnë dot.

Andaj shtrohet pyetja se sa shteti ynë është i gatshëm në luftimin e kësaj dukurie ose thënë ndryshe çfarë rezultatesh ka dhënë në parandalimin e së njejtës?.

Nga hulumtimi i bërë i kësaj teme nga statistikat e marra nga gjykata e Gostivarit si dhe entit statistikor shohim një rezultat mjaftë të dobët në uljen e numrit të grabitjeve apo vjedhjeve grabitqare, duke mos ndërhyrë më thellë pasi që edhe statistikat janë vetëm numra nëse analizojmë të vërtetën pasi që jam vet dëshmitar në kryerjen e veprës penale të vjedhjes e cila ka ndodhur në shtëpinë e një banori të një fshati nga rethina e GV edhe atë 4 herë që të katërt herë ka ardhur policia duke marrur gjurmë, gjurmë të cilat bukur mirë dalloheshin ku edhe një person i pa shkolluar i sheh por ndodhi rasti që kryerësit asnjëherë nuk u kapën, andaj mundë të shohim rolin e shtetit me organet kompetente se sa të zotë janë në luftimin e së njejtës e le më në parandalimin e saj.

Pastaj nëse analizojmë egzekutimin e sanksionit ku ata kryerës që janë gjetur dhe kanë marrë dënimin e duhur duhet analizuar edhe kushtet të cilat i posedon sheti ynë. Për sa i përket kushteve gjatë studimeve deri diplomike fakulteti i evropës juglindore na mundësoj vizitën e burgut të Idrizovës ku në atë burgë pohonte vetë drejtoresha për kushtet mjaftë të vështira për mbingarkesën e personave të dënuar, ku kemi mësuar se qëllimi i dënimit ka një përmbajtje që është risocializimi që luan rolë mjaftë të rëndësishëm në riintegrimin e personit në një jetë normale, andaj shtrohet pyetja se sa një kryerës mund që të risocializohet në këtë burg të tillë apo në ndonjë ent tjetër, një problem mjaftë i madhë ku edhe shumë qytetarë të themi kanë te drejtë në fjalën ku thuan atje do hutohen më shumë se sa do të përmirësohen.

Pasi që nga studimet e bëra kemi mësuar se kusht numër një i enteve është klasifikimi i kryerësve sipas veprave të kryera si p.sh ai që ka kryer grabitje, nuk mund të që vendoset në një qeli me një grabitqar tjetër sespe bashkimi i të dyve do të bënte fuqi në zhvillimin dhe formimin e idejva të reja në kryerjen e veprave të ardhshme në mënyrë më profesionale. Pasataj për sa i përket asaj që thamë më lartë kapaciteti i të dënuarve në Idrizovë është diku te 800 e burgu në fjalë ka diku mbi 1500, kjo lëre se ndikon tek kryerësit por mund të konstatojmë se nga numri i tepëruar edhe shqipimi i dënimeve tjera për të njejtat vepra mund të jetë i dënimit më të butë krahasim me dënimin e merituar.

Nga e gjithë kjo që thamë në shumicën prej neve do të lindë pyetja se çfarë duhet që të ndërmeret që kjo dukuri të luftohet mos të themi të parandalohet .

Duke parë më lartë ato faktorë që i përmendëm konstatojmë se pikërisht ata janë faktorë bazë që çojnë një individë deri në vjedhje sepse tek vepra e vjedhjes nuk mund që të përkrahim teorin e Qezaro Lombrozës për kriminel të lindur besoj që asnjëri nga ne nuk do donte të jetë vjedhës, sespe ka lindur i tillë, pasi që hajdut nuk lind por bëhesh!. Këtë e them duke e marrë piksëpari nga vetja ime nuk është aq e kollajshme të kryejsh vjedhje por ka diçka që të shtynë në kryerjen e së njejtës si p.sh ato faktorët objektiv ekonomia papunësia etj etj.

Si përfundim ajo çka duhet në parandalimin e grabitjes apo vjedhjes grabitqare, apo në tërësi në parandalimin e veprave penale kundër pasurisë arimë në konkludim se është hapja e vendeve të punës, përmirësimi i pagave që të jenë ekuivalent me jetën në vendin ku jetojmë jo psh rasti i gjobës në komunikacion një gjobë 400 euro e rroga mesatare 300 euro, të menjanohen kësisojë rastesh, të egzistoj barazia, të respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut, si në perëndim, me hapjen e vendeve të punës me një pagë të mirë do krijohet një harmoni familjare pastaj mund të them me bindshmëri se vejdhjet do jenë në numër të vogël, dikush mund të parashtrojë pyetje nga ky konkludim, ky konkludim mjaftë i thjeshtë merr shembul shtet perendimore respektivisht Skandinavët numri i paupnësisë diku 1 përqind dhe numri i vjedhjeve në numër mjaftë të vogël. Nëse nuk mundë që shteti ynë të hap objekte të reja ku do të punësoheshin persona me profesione të ndryshme atëherë le të

mundohet ne bashëpunimin me shtetet tjera në sjelljen e firmave të sheteve të huaja në vendin tonë e jo tu vështirësoj atyre procedurat apo legalizimet e investitorve të huaj.

Pra nga e gjithë kjo konstatojmë se në parandalimin e veprave penale kundër pasurisë deri në kryerjen e këtyre veprave luan rol faktori i papunësisë, ekonomisë, dhe për ndalimin e kryerjes së vjedhjes vimë në përfundim se nevojitet vende pune me paga dhe kushte të mira, ku mund të konstatojmë që nëse këto relizohen atëherë vjedhja më do ishte në numër të vogël, pasi që sa i përket rethinës të Gostivarit pikërisht në fshatra të ndyrshëm më parë ka qenë migrimi me i vështirë dhe un si adoleshent dëgjoja, mjaftë për kryerje të vjedhje të ndryshme, por këto 3 vitet e fundit respektivisht vjet dhe ktë vit mund të them që asnjë rast vjedhje ska patur arsyeja ka qenë fakti se shumë të rinjë apo më të vjetër kanë emigruar kanë rregulluar jetën e tyre dhe kështu që për të kryer vjedhje skanë interesim.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

LIBRA

1. Ismail Zejneli, E Drejta Penale pjesa e posaçme, Tetovë, 2007
2. Asllan Bilalli, Bedri Bahtiri, E Drejta Romake, Prishtinë, 2015
3. Ivo Puhan, E Drejta, Romake, Tiranë, 2007
4. Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2011
5. Salihu Ismet, Hasani, Fejzullah, Zhitia Hilmi, Komentari i Kodit Penal të Kosovës, Prishtinë, 2014
6. Salihu Ismet, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Prishtinë 2011
7. Shtjefen Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukuagjinit, Tiranë, 1999
8. Ismet Elezi, E Drejta Zakonore Penale e Shqipëtarëve dhe lufta për zhdukjen e mbeturinave të sajë në Shqipëri, Tiranë 1983
9. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011
10. Vllado Kambovski, Nikolla Trupançevski, E Drejta Penale Pjesa e Posaçme, Shkup 2011
11. Afrim Osmani Kodi Penal i R.M-së, 2015
12. Илија Симић, Кривични Законик, практична примена, Службени Гласник, Београд 2007
13. Vllado Kambovski, Komentari i KPM, Shkup 2011
14. Petar Novoselec, E drejta penale Pjesa e Posaçme, Zagreb 2007
15. Ismet Elezi, E Drejta Penale Pjesa e Posaçme, Tiranë 2002
16. Ismet Elezi, E Drejta Penale Pjesa e Posaçme, Tiranë 2014
17. Aleks Nikolli, Kodi Penal i R.SH-së, Tiranë 2016
18. Delo Meçani, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Komentari i Përditësuar Tiranë 2017
19. Vllado Kambovski, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Shkup 2010
20. Afrim Osmani, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup 2013
21. Никола Срзентић, Коментар Кривичног Закона Србије, Београд 1995
22. Ђорђе Игњатовић, Криминологија, Београд 2008
23. Наташа Пеливанова, Мерки на безбедност од медицински карактер Скопје 1996
24. Bajram Ukaj, Dënimet në të Drejtën Penale të Shqipërisë, Prishtinë 2006
25. Crime and Criminology ninth edition, Sue Titus Reid, Florida State University 200
26. Edmond Dragoti, Psikologjia e Krimin, Tiranë 2011
27. Jacqueline.B.Helfgott, Criminal Psychology, USA 2013
28. Ragip Halili, Vitkimologjia, Prishtinë 2011
29. Ejup Sahiti, Ismail Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale, të R.M-së, Univerziteti i Evropës Juglindore në Tetovë 2017
30. Natasha Pelivanova, Merki na bezbednost od medicinski karakter, Shkup 1996

BURIME TË TJERA

LIGJE KODE NJOHURI TJERA

- R.M. Ministria e Drejtësisë, Strategjia e Reformave në të Dretjën Penale, Shkupë 2007
- Ligji për ndryshim dhe plotësim i KPM, Gazeta zyrtare e R.M. nr139 prej 04.11.2018
- Ligji për ndryshim dhe plotësim i KPM, Gazeta zyrtare e R.M. nr114/09
- Ligji për ndryshim dhe plotësim i KPM, Gazeta zyrtare e R.M. nr51
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare nr.52/91
- R.M. Ministria e Drejtësisë Kodi Penal, i R.M-së nenet 122 (paragrafet 28,32, 33,38), 237,238,
- Kodi Penal i R.SH. nenet 134-141
- Ligji për egzekutimin e sanksioneve (Gazeta zyrtare nr. 2/06, 84/08, 57/10)
- Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e RM nr.150/10)
- Disa fjalime janë bazuar nga njohuritë në bazë të ligjeratave deri dhe post diplomike nga Ismail Zejneli, Besa Arifi
- Raste studimi, të marra nga gjyqëtarë të qytetit të Gostivarit, dhe Tiranës
- Neni 12 alineja 1 nga Kodi penal i RM-së Gazeta Zyrtare nr. 37/96
- Neni 63 alineja 1 nga Kodi penal i RM-së, Gazeta Zyrtare nr. 37/96

BURIME NGA INTERNETI

- www.stat.gov.mk
- www.mvr.gov.mk
- www.pravo.org.mk
- http://www.bhel.com/dynamic_files/press_files/pdf/pdf_14-Mar-2005.pdf
- <https://books.google.mk/books?id=6SmSAGAAQBAJ&printsec=frontcover&hl=mk#v=onepage&q&f=false>
- <http://www.pasqyre.al/te-gjitha/te-pasura-por-hajdute-vip-at-qe-vuajne-nga-kleptomania/>
- <http://www.dusunenadamdergisi.org/ing/fArticledetails.aspx?MkID=1046>
- <https://askopinion.com/famous-celebrities-who-are-kleptomaniac>
- <https://legal-dictionary.thefreedictionary.com/robbery>

